BUZUKU-b

Revistë e pamvarur informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e hëne më 15 korrik 2013

numër 39



fq. 12



fq. 10



KONSTANDINI
1700 VJETORI I EDIKTIT TË MILANOS
DHE LIRIA FETARE

CONSTANTINE
1700 ANNIVERSARY OF MILAN EDICT
AND RELIGIOUS FREEDOM

SIMPOZIUM

27/04/2013

Hotel Tirana International



fq. 4

TË SHKOJMË MIRË NJËRI ME TJETRIN

Gjokë Dabaj (diskutimi) (shestanas ptej Gurzës, Shestani Nalt, perëndimi i Krajës, tash në Durës)

Më 11 qershor 2013 u mbjat në Ulqin një tubim promovimi të librit "***Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve***" (kumtesat e një konference shkencore, mbajtur në Ulqin më 7-8 tetor 2011) Isha i ftuar. Pata përgatitur një diskutim me titull ***"*Krahënia, në furtunat shumëshekullore***". Por, kur shkova aty, pashë një gjendje krejt ndryshe. Më një krah, një tubim njerëzish të përkushtuar për çështjet që na preokupojnë ne shqiptarët e atyre anëve, në krahun tjetër, në një hije ogurzezë, mungesa skandaloze pikërisht e atyre njerëzve që duhej të ishin aty. Ç'të kish ndodhur? Përçarje e zakonshme prej meskinësh dhe interesaxhinjsh dritëshkurtër e zemërvegjël, apo diç më e rrezikshme?! Prof.Dr.Simë Dobreci, promotor i patriotizmit të shqiptarëve të atyre trevave ishte bojkotuar pikërisht prej kryesisë së shoqatës "***Dom Gjon Buzuku***" dhe prej shumë të tjerëve. E ndryshova diskutimin dhe mbajta aty këtë fjalën

TË SHKOJMË MIRË NJËRI ME TJETRIN!

Jemi një popull, kemi një gjuhë, kemi një histori, kemi të njëjtën kulturë etnike. Prandaj, botimi i këtij libri, i cili na tregon shumë gjëra prej kësaj kulture të përbashkët dhe tepër të lashtë, duhet të na shërbejë që shestanasi ta ndiejë veten shpirtërisht sa më afër me kranjanin e Kranjës së Poshtme dhe kranjani ta ndiejë veten më afër me shestanasin. Po kështu edhe ulqinaku.

Dhe, kur themi që kranjani të shkojë mirë me shestanasin, se në kuptimin më të gjerë, kranjanë janë që të dy, kjo nuk do të thotë që ne të mos shkojmë mirë me cërrniçanin, me kuçasin apo me pashtroviqasin. Përkundrazi, edhe me ata duhet të shkojmë mirë, se edhe me ata duhet të bashkëjetojmë. Mirëpo, jo me servilizëm, sepse ai pastaj ka të drejtë edhe të na nënçmojë.

Në qoftë se unë ia fsheh cërrniçanit që jam shqiptar nga Shestani, në një kohë kur ai e di fort mirë kush jam unë, a nuk bën kjo që ai të më përçmojë mua e të më përbuzë?!

Dhe, kur themi që ne duhet të shkojmë mire me cërrniçanin, këtu duhet të nënkuptojmë që të përpiqemi t'i mësojmë edhe atij të flasë sadopak shqip. Përse të mos i dijë 5 fjalë shqip një malazias i Cetinjës, në rast se jeton në të njëjtin vend me mua?!

Kur themi: Të shkojmë mirë, kranjanë, shestanas, anamalas, ulqinakë e mamalazezë, kam parasysh edhe përkatësinë fetare. Çështjen e qëndrimit ndaj besimit të ne shqiptarët e kanë zgjidhur më së miri rilindësit tanë të mëdhenj: Një Zef Juban, një Pashko Vasë, një Ndre Mjedë, një Gjergj Fishtë, një Naim e një Sami Frashër, por edhe këtu në Ulqin një Cafobeg Ulqini.

Prandaj, ne nuk ka pse bëhemi "më të mençur" se këta që i përmenda. Dhe duhet ta dimë që ata rilindës nuk e kanë pasur të lehtë për t'i vënë këto gjëra në rrugën më të mbarë të mundshme.



Gjokë Dabaj

Unë nuk them që një ulqinak mysliman të mos gëzohet kur e fejon vajzën e vet, ta zëmë, në Sarajevë. Të gëzohet dhe le të jetë e lumtur vajza e tij me burrin që ka zgjedhur. Por unë jam kundër asaj që një mysliman ulqinak të hidhërohet nëse vajza e tij, rastësisht, dashuron një djalë katolik nga Bratica.

Le ta marrë shestanasi malazezen, por ajo të mësojë shqip në familjen e burrit të vet dhe fëmijëve t'u mësojë gjuhën shqipe. Përndryshe, ai burrë, për fajin e tij, do të mbetet, në sytë e asaj gruaje, qyqar gjithë jetën. Në sytë e saj gruaje, por edhe në sytë e të tjerëve. Madje edhe në sytë e fëmijëve të vet dhe fëmijët e tij kurrë nuk do të mund ta ndiejnë veten krenarë para askujt.

Në familje, aq më pak në krahinë, aq më pak midis krahinavet, pikëpamjet nuk formohen me IMPONIM: Pikëpamjet, politike, fetare, kombëtare e çfarëdo qofshin, formohen te tjetri vetëm me mekanizmin e ndikimit, me influence, me shembullin vetjak dhe mbi të gjitha me zemërgjerësi.

(Nuk desha të them: Pikëpamjet në të njëjtën organizatë, siç po e shihnim, me shumë indinjatë, në atë mbledhje promovimi.)

Jemi vëllezër, thashë në fund, dhe nuk ka asnjë arsye ta shohim njëri-tjetrin shtrembër, sepse ai po mendoka ndryshe nga unë.

Prandaj dhe po them që ky libër është i mirëseardhur midis nesh dhe urojmë që në të ardhshmen të kemi edhe shumë studime të këtyre fushave.

(Në promovimin e këtij libri nuk qenë të pranishëm as drejtuesit e Qendrës së Studimevet Albanologjikë të Tiranës. Çfarë kishte ndodhur?! Mos kish futur dikush përçarje midis nesh me qëllim?!). Ulqin, 11 qershor 2013.



PËRMBAJTJA

2.Të shkojmë mirë njëri me tjetrin
3.Njoftime. Autoriale. Grekët dhe Skënderbeu
4.MASAKRA E TIVARIT – konferencë
5.Turqit të përzene ka dera, ri-hyjen ka dritësorja
6.Kuvedi i Arbënit – 310 vjetori
7.Peticion i intelektualëve kundër rishikimit të historisë
8.Në Shas zbulohen edhe tri kisha
9.Diskriminimi i shqiptarëve në Greqi
10. Konstantini i Madh në kontekstin dardan dhe Dardani
12.Përmendore e kujtesës historike të Shestanit e Krajës
13.Të dhëna me përmasa enciklopedike
14. Shqiptarët festojnë 100 vjetorin e pavarësisë në Nju-Jork
15. Me dalë n'me t'Rumisë. Vallja e Shestanit në Podgoricë
16. Principet e përdorimit racional të antibiotikëve
17. Shkolla shqipe në Zllakuqan - 115 vjetori
18. Shpërngulja prej Kosovës për Turqi
18. Lugina e Preshevës proteston
19. Dita e mësuesit u festua. U përuruan 2 libra
20. Bahri Brisku na dha edhe një libër
21. Rrëfin i birit Ulqin
22. Mërgimtarët nga Amerika ndihmuan Shtëpinë e Shëndetit
23.Të ndryshme
24. Dalja në Rumi. Dueje gjuhën tane

BUZUKU-b 39

REVISTË E PËRKOHSHME INFORMATIVE, KULTURORE E SHOQËRORE

Këshilli programor:
Mr. Rrok Gjolaj, prim.dr.Gani Karamanaga, prof.dr. Mentor Disha, prof.dr.Hysni Hoxha, prof.dr.Jahja Drançolli, Lekë Brisku, Mitër Pekaj, Gjystina Dabaj, Gjergj Perkolaj, Mark Junku, Gjurë Dabaj

Kryeredaktor:
Simë Gjon Dobreci

Zavendës i kryeredaktorit
Gjergj Anton Filipaj

Ndihmës të kryeredaktorit
Gjekë Gjonaj
Bahri Brisku

Redaksia:
Mr. Riza Rexha, prof.dr. Ruzhdi Ushaku, Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, Idriz Ulaj, Loro Markiqi, Ali Gjeçbritaj, Pjetër Ivezaj, dr.Lukë Gjokaj, Kolë Camaj, Drane Marvuçiqi, Gjokë Dabaj
Fotoshërbimi:
Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto Prishtinë, Foto Bruno
Realizimi artistik:
Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:
Braticë
85360 ULQIN
Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943
www.buzuku.info
E-mail: fdobreci@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse
Banka komerciale malazeze A.D.
Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40
Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Njoftim me rëndësi botërore



Kuvendi i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 17.12.2012, miratoi rezolutën: **Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë është më 5 shtator, data kur ndërroi jetë Nana Tereze.** Pra, u vërtetua: **Nana Tereze është Shqiptarja që e nderon krejt bota.**
Nana Tereze lindi më 26.8.1910, në Shkup, Maqedoni, kurse ndërroi jetë më 5.9.1997, në Kalkutë, Indi.
***
Çdo shqyptar, kudo që jeton e vepron, ka arsye të plotë, të mburret me Nanën Tereze, si dhe të krenohet e të burrnohet që është shqyptar.

Lexues t'neruem

Po ju flas n'gjuhën shqype t'shestanasve, n'gjuhën e amël qi ma suen nana e baba.
Borçi jem isht me ju kalxue, pse kyj numër i revistës BUZUKU po del me nji fizionomi tjetër, si botim privat, me nji shkronjë ma tepër në emën t'revistës. Për katër numrat e funit t'BUZUKUt nuk pata asnji nimë pej shoqatës DON GJON BUZUKU. Ata n'krye t'Shoqats m'thonjin: Mos e boto. E kuptova qi po e pengonj punën e tyne. Isht nji fjalë e moçme: Kurë pengon, largou sa ma parë. Bjesedova me disa t'Këshillit programor dhe t'Redaksisë t'revistës, si dhe me miq e dashamirë. Ata m'kshilluen: Revista BUZUKU le t'dale edhe n't'ardhmen, por si revistë e pavarun, jo e lidhun për donjë shoqatë. E dhanë edhe fjalën qi do t'me nimojnë, si edhe m'kanë nimue për 4 numrat. E nigova fjalën e tyne.
Nëse ka nevojë, edhe n't'ardhmen jam i gatshëm me nimue Shoqatën me emnin e Don Gjon Buzukut, t'burrit qi më 1555 shkroj MESHARIN, librin e parë n'gjuhën shqype.

Simë Gjon Dobreci

Kur grekët adhuronin dhe i faleshin Skënderbeut

Edhe pse duket paradoksale, apo e tepruar, përgjigja më e mirë që mund t'i jepej nacionalistëve grekë është së paku, kjo fotografi!



Është shkruar në gjuhën greke dhe është një foto me vlera historike, pasi mosha e saj humbet në thellësinë e shekujve, raporton "Alb-Observer"..
Në të shkruhet në greqisht:
Gjergj Kastrioti, i titulluar Skëndërbej, Mbreti i Shqipërisë
Është e mjaftueshme për një përgjigje të lehtë, por të dhimbshme ndaj neo-nazistëve të cilët po ndjenjë të humbasin tokën nën këmbë nga faktet tronditëse që dalin dita ditës në dritë, fakte këto që lëkundin historinë e shtetit fqinjë...!
Për më shumë duhet theksuar fakti se dikur, në periudhën kur kjo fotografi u krijua, Prijësi i Shqipërisë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ishte idhulli dhe hyjnia shembullore për gjithë grekët…!
Marrë prej Moderator lidhja-çame_moderator.lidhja came@yahoo.com ; publikuar më 10.01.2013.

“Masakra e Tivarit” - konferenca

Shkruan **Ismet Kallaba**



Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi organizoi më 30-31.3.2013 në hotelin “Mediteran” në Ulqin Konferencën shkencore “Masakra e Tivarit 1945”. Rreth 30 studiues shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, por edhe pjesëmarrës dhe dëshmitarë të saj, në kumtesat, kujtimet dhe dëshmitë e tyre, kanë hedhur dritë në një ndër krimet më të mëdha të kryera ndaj shqiptarëve në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur u masakruan disa mijëra Kosovarë.

Kryetari i KNSH-së, Tahir Tahiri, ka thënë se kjo masakër e paparë ndaj shqiptarëve është heshtur 68 vite dhe kjo Konferencë shkencore është një hap drejt zbardhjes përfundimtare të kësaj tragjedie të madhe për shqiptarët.

Ana Lalaj, historiane nga Tirana, prezantoi kumtesën “Masakra e Tivarit, tipar dhe kulm i dhunës ushtarake jugosllave në Kosovë”. Ajo tha se në këtë tubim dolën dokumente, dëshmi për atë që kishte ndodhur në Tivar, dëshmi për qëndrimin e aleatëve, për brigadat shqiptare. Pjesa më e madhe e studiuesve vlerësuan se ka akoma shumë punë për t'u bërë. Ne jemi këtu për t'i thënë botës që kjo ndodhi në Kosovë. Ne jemi për të nxjerrë të vërtetën, sepse vetëm kështu do të na dëgjojnë, vetëm kështu do të na respektojnë, u shpreh ajo.

Historiani Uran Butka ngaTirana, autor i librit “Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar” tha se ky është një tubim historik institucional; plagët që kanë mbetur mbyllen duke e treguar të vërtetën; shteti shqiptar, shteti i Malit të Zi, i Kosovës dhe i Serbisë duhet t'i kryejnë obligimet e tyre shtetërore duke kërkuar ndjesë, kurse të ndëshkohen ata që kanë bërë krimet. Në këtë frymë folën edhe prof. dr. Jusuf Bajraktari (drejtor i Institutit të historisë në Prishtinë), deputeti Mehmet Bardhi, Osman Subashiqi (nënkryetar i Komunës së Tivarit), si dhe Banush Pllana (dëshmitar nga Kosova).

Pas punimeve, studiuesit dhe pjesëmarrësit e tjerë të Konferencës kanë vizituar ish godinën e Monopolit të Duhanit në Tivar, ku sipas dëshmive janë vrarë pjesa më e madhe e shqiptarëve. Para kësaj godine, është mbajtur një minutë heshtje dhe është vendosur një kurorë me lule në shenjë kujtimi për viktimat e kësaj tragjedie.



Korrigjim
Në BUZUKUN 38, faqe 12, në regjistrin e emrave nën fotografi, në numër 15 gabimisht figuron emri Fisnik Dobreci, e duhet Ilir Kollari. Kërkojmë falje nga lexuesit.

Turqit, te perzene ka dera, ri-hyjen ka dritësorja

Shruan **Agostino Giordano,** drejtor i revistës ”Jeta Arbëreshe”*

1468-1912. Shqiperia u zgjith ka**(nga) hekuret e Turqvet 444 vjet pas vdekjes se Skanderbekut. Nje mot i gjate. Na Arbereshe, te peshtuar nde (në) Talljet (Itali), rruam te lire e te krishtere, ruajtim gjuhe e zakone, e adhe (ende) i kendomi Skanderbekut nder vallet e Pashkevet; kurse, nde (në) Shqiperì, nen sundimin e eger turk-osman, lirì-ndere-begaterì i patetin (patën) vetem shqiptaret çe (që) tradhetuan besen e krishtere, Skenderbeun e gjuhen shqipe; per gjithe te tjeret, filaqì (burg)-vdekje-depertime-taksa. Nje mot i gjate. I eger.

Ndersa ne Arbereshe kishim qendruar te krishtere, skanderbek jane e antiturq. Shqiptaret (në Shqiperi) daledale qene shtrenguar te izlamizoheshin, me hir o pahir; me motin (kohën) pat 'adaptoheshin (u patën adaptuar) nji situatje fetare te perzyer; mendojin –me se gjithe intelektualet e qisha (kisha) katolike – se, per te shpetuar Etnine Shqiptare dhe paqen sociale, besimet fetare kish (duhet) te bashkejetojin. Fishta (i krishtere) e Frasheri (mysliman) ne krye. Nje fitore per izlamin, nje mundje per Krishterimin.

Keshtu u le (lindi) Shqiperia e Pavarur, te viti 1912: me izlamike se e krishtere. Ismail Qemali e Delegatet e Vlores, diten 28 shenmartir (nëntor) 1912, me qene se politikisht ishin e shqitjin (çngjitnin) Shqiperine ka (nga) perandoria izlamike turk-osmane dhe deklarojin pavaresine e saj te plote, kish t'e kishin pjerre (duhet ta kishin kthyer) 444 vjet prape edhe me Besen. Domethene kish (duhet) t'kishin deklaruar jo vetem pavaresi politike po edhe pavaresi fetare. Besa e Krishtere si Fe Zyrtare. Po s'vate keshtu, e kush e qajti me shume qe Historia. Ajo me “H”-ne e madhe.

Historia rrefyen se Shqiperia qe i sprasmi Vend i Krishtere ne Ballkan ç'i beri balle Turqvet; dhe Skanderbeku qe i sprasmi “Luftetar i Kryqes”. Prirja “e plote” ndaj rrenjavet te krishtere do t'i kish njohur te drejten Shqiperise, Skanderbekut dhe Historise. Ashtu kish dashur, po s'qe. Sepse Turqit, gjate 444 vjet sundimi, atij populli shqiptar, ç'i kish luftuar heroikisht per dhjetra e dhjetra vjet, i rezervuan nje izlamizim t'eger, t'thellem (te thelle): pothuaj i bene nje transplantim kirurgjik te Dna-se se tyj etno-fetar.

Enver Hoxha, pra, – gershìze(qershize) e kuqe mbi torten – nder 44 vjet te diktatures se tij komuniste, si ateist ç'ish, i vu gjithe dakord Shqiptaret: ja



fshijti teresisht keto dy besa, ka zemra e ka mendja: mbellijti (mbylli) xhamì e qisha (kisha), po torturoi e vrau pothuaj vet (vetem) priftra. Pestaj, si ra regjimi komunist, te viti 1990, shpresohej se, me Republiken e re, zenej nje histori tjeter per Shqiperine: jo vetem nga ana politike po edhe nga ana fetare. Nje histori e krishtere.

S'qe keshtu, sepse ne Shqiperi s'lehen (lindin) me heronj si Gjergj Kastrioti, as nder qisha (kisha) as nder shpi; dhe kushtet ne Ballkan s'jane me ata te motit skanderbekjan: izlamizmi shtiu rrenje te thella ne territoret illire. E bjerre keshtu lufta fetare, mendohej se, sadopak nga ana politike e historike, Shqiperia – bashke me te rene Republike Kosovare – i prit raportet diplomatike me Turqine, o, sadopak, i mbanej te vaket, dhe s'i lejonej Turqise te kllite (fuste) hunden njeter (nje tjeter) here mbrenda kufijvet te saj.

Krahina serbe e Kosoves, ne vitin 1999, kish t'kish (duhet ta kish) kundershtuar, me Ibrahim Rugoven ne krye, pranine turke nde (në) mes t'fuqivet ushtarake te Onu-sit çe (që), asì viti, ndihu (ndihmoi) Kosovaret kunder Serbise. Jo, s'qe keshtu. (Po Europa e krishtere, te viti 1952, kish t'kish (duhte ta kish) kundershtuar hyrjen eTurqise ne Aleancen Nato! Ashtu si, sot, Shqiperia e Kosova kish te kundershtojin hyrjen e Turqise ne gjirin e UE-se). E nanì (tash) Turqia – nje republike çdo dite me izlamike – pas 444 vjet pushtimi historik te Kosoves, i paraqitjen Republikes se Kosoves llogarine e saj historike me kripe. Mbi shtypin shqip keto dite djovasa (lexova) se *“dy vjet pas vizites se Kryeministrit te Turqise ne Kosove, Recep Tayyip Erdogan, jane ndryshuar librat e ciklit parauniversitar* (te shkollavet te Kosoves, ndr.) *ne raport me kohen e Perandorise Osmane. Ne versionin e ri te historise, Perandoria Osmane eshte nje pushtues, por jo nje sunduesi eger”*. Me vjen te qanj! 544 vjet pas vdekjes se Skanderbekut, Turqia u pruar te sundonje njeter (këssaj) here Kosoven shqiptare. S'i sosi se i nderroi fé-emre-ndergjegje tere etnise shqiptare ne Ballkan, nanì (tash) do t'i nderronje edhe historine! Mos ndien turpe, perpara tere Botes, si i sundoi egersisht per 444 vjet?

Po kete here s'ftesen (nuk e ka fajin) Turqia, ftesjen (fajin e kane) Republikat “e pavarura” te Kosoves e te Shqiperise çe i nenshtrohen njeter (këssaj) here sunduesit shekullor. Nje fare masokìzmi (*e kunderta e sadizmit*) te pakuptuashem!

Na Arbereshe e njohmi mire Historine: tonen dhe te shqiptarvet. Per ne, Turqit ishin dhe qendrojen armiq. Per ne, liria-besa e krishtere -gjuha-Skanderbeku neng (nuk) ngiten! Gjergj Kastriotin na e nderomi ende nder Vallet e Pashkevet.

Marrë prej revistës online* **Jeta Arbereshe, nr. 74, viti/anno XI llonar-shendrè / luglio-dicembre (korrik-dhjetor) 2012. Botohet në Kozencë, Itali. E-mail: **Agostino Giordano** <jetarbreshe@libero.it> http://digilander.libero.it/jetarbreshe

**Fjalët që mund të jenë të pakuptueshëm për lexuesin, e kanë shpjegimin në kllapa (për çka i falënderohemi autorit).

Ujku e nrron qymen,
por sifatin kurr
(popullore)

Kuvendi i Arbënit - 310-vjetori

Përgatiti: **Paul Tedeschini**
<paul.tedeschini@yahoo.it> 14 Jan 2013.

Kuvendi Kishtar Shqiptar i Arbënit i vitit 1703 mbrojti të vërtetat e fesë së krishterë dhe identitetin kombëtar e gjuhën e popullit shqiptar.

Pra më 14 e 15 janar të vitit 1703 në Mërqi afër Lezhës qe organizuar Sinodi apo Kuvendi i Kishës katolike Shqiptare, i njohur si Kuvendi i Arbërit. Është fjala për një Sinod apo Koncil i Kishës Katolike në trojet Shqiptare, organizuar me kërkesën e Papës Klementit XI Xhanfrançesk Albanit, me prejardhje shqiptare, i cili këtë ngjarje të madhe kishtare e kombëtare shqiptare, ia besoi kryeipeshkvit të asaj kohe të Tivarit, imzot Vinçenc Zmajeviçit Kështu, në Kishën e Shën Gjonit të Merqisë, tri kilometra në veri të Lezhës, nën drejtimin e Imzot Vinçenc Zmajeviçit, mblidhej Kuvendi i Arbënit, apo mbledhja e parë e Krerëve të klerit katolik mbarë shqiptar, ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme për fatet e Kishës katolike në trojet shqiptare e të identitetin kombëtar e të gjuhës shqipe ndër shqiptarë. Ishte pra data 14 janar 1703 e Kuvendi do të vijonte edhe të nesërmen, më 15 janar gjithnjë të vitit 1703.

Më 28 janar të vitit të largët 1704 Kongregata për Ungjillëzimin e Popujve, që njihej me emërtimin latin “Propaganda Fide” miratonte botimin e dokumenteve të këtij Konçili.

Askohe në fronin e Shën Pjetrit ishte ulur Papa shqiptar, Kelmendi XI, i cili i pati kërkuar Imzot Vinçenc Zmajeviçit, Kryeipeshkëv i Tivarit, të kryente vizitën kanonike në të gjitha kishat dhe qendrat katolike të Shqipërisë. Pas vizitës, që e kreu brenda tre muajve; në dhjetor 1703, prelati mblodhi në Kuvend kryetarët e klerit: 5 ipeshkvijtë e dioqezave të vendit dhe provincialin e Françeskanëve.

Në përfundim, vendimet e Konçilit, shkruar në shqip e latinisht nga vetë Imzot Zmajeviçi, iu paraqitën për shqyrtim Papës dhe, pas miratimit më 28 janar 1704, u botuan nga Propaganda Fide nën titullin “Kuvendi i Arbnit o Koncili Provinciall i mbledhun Vjetit mijë shtatqind e tre ndenë Shqiptarin Klementin XI papë Pretëmadhin”. Imzot Zmajeviçi i përcillte dokumentet me letrën që vijon, përmes së cilës shihet qartë se kleri shqiptar i qëndroi pranë në gaz e në vaj popullit të vet dhe i parapriu rilindjes së tij kombëtare. Me që kanë kaluar pothuajse treqind vjet që kur u shkrua, u detyruam ta prekim paksa gjuhën e saj, për ta bërë të kuptueshme për lexuesin: “Urdhnove, o i Lumtuni Atë, me të vizituem Apostolik, të vërej mbi Kishat e Arbënisë së provinçës seme. Ju binda urdhënit; ju solla dheut; kërkova rruzullimin; pashë plagët e tij. Pashë, – uh, ç'dhimbje, – vu nën haraç atë që dikur kje despoti i Provincjave; (pashë) (Shypninë) Zonjën e gjindëve ndrydhë nën thember, me dhimbje të idhta; shqytin e trimave – shembë; murin e forcës sonë – rrenue! Pashë gjindt, hy në vend shenjt; kishat, të flligta; lterët



përlye. Mezi pashë vend ku të mundej populli me u mbledhë në kuvend! Pashë pleqtë tue ulurue; Meshtarët, shërbëtorët e Hyjit, tue gjimue; çobantë, vra; dhentë tretë, tue u shpërnda dy udhëve; murtajën, që pa mëshirë i çoroditëte të gjithë; e plasjen e mortaisun, që trimnohej për të gjanë e për të gjatë. Këto pashë e gjimova! U përzien përmbrendcat e mia prej dhimbe për popullin tem e m'u coptuen, tek shihshe mundimet e bijve që po mbyteshin. Tue pamë këta, thashë, populli em u ba rob, përse s'pat dijen. Tue ankue kaq të këqija e ngushtica të paudha, edhe mue më shtrëngoi ngushtica; por, për sa paçë fuqi, nuk lashë ilaç pa përdorë. Nevoja e lypte me gjetë shtigje ma të mira se vizita, as lente moti me e shtymë. Ndihma ma e madhe do të ishte mbledhja e Konçilit. Këtu i përqendrova fuqitë, këtu ngula mendtë, tue ia himë, pa rrenë, një pune ma të randë se kishe fuqinë. Po Ai, që i ka ndihmue vëllazënt tanë, që ishin përdamë nëpër rruzullim të Fesë, më ndihmoi edhe mue në këtë vend. As detyra që kam, si çoban i shpirtnave, as kujdesi i fortë, që kam për të krishtenët e as mendët e mia të pa afta, nuk do të mujshin me e krye një detyrë kaq të randë. Po Hyji, i cili ndërron motnat e doket, që ep të rritunit e mbaron gjithë punët, Ai bani që një detyrë kaq e vështirë të kryhej si pata dëshirue.

Nën hije Tande, o i Lumtun Atë, po gëzon dheu Arbënesh e mbas ndërrimit të motit ngrihet, sikur të kishte kenë i mbuluem me njegull, tashti nën papën arbënesh, që latinisht don me thanë i bardhë – e del në dritë, e me zemër të mirë shpejton me mërrijtë përsëri në lumni të shkueme. Mendja e Atit, e cila asht ma e madhe se rrethi i shekullit, i uron me dashtëni të TinZot këtë lumni dheut tonë; për t'iu falë nderës zemrës gazmuese, vijnë si për dhanti në shatorre Apostolike, në katedër të dijes qiellore, Dekretet e Sinodit të Proviçjes Arbëneshe, në mënyrë që, në paçin gabime, të qortohen me fjalë Tande.

Unë, pra, në paça gabue si Prelat Arbënesh, vij te magjisteri i Pjetrit me u qortue; e nuk më vjen marre me i kthye ndryshe fjalët. Nuk kanë kurrfarë vlere veprat tona të errta; asgja nuk vlejnë Dekretet, në se nuk mbështeten mbi Gurin e palëkundun; e si të jenë provue mbi gurin e fortë, të forcohen me profeci të pushtetes sate. Pëlqe, pra, o i Lumtuni Atë, dhantitë e nderimet e përvujta, sheje të Kombit tem, por ma fort tandit. E, n'e pashë se ndokund puna duhet lëmue, godite e ndreqe me gjykimin e shenjtnueshëm e të pagabueshëm… Po, sepse kështu këto pak të falna, që përkojnë me vobësinë tonë, me gjykimin e hyjnueshëm pagabim kanë për t'u shumue fort. E ndërkaq unë, me vëllazën të mij të tjerë të Arbënisë… lusim Hyjin t'ju ruejë Ju, Papën Arbënesh Pretmadhin, për shumë mot në Kishë e edhe ne të na ruejë shëndosh pa kurrnjë të keqe…

Shkrue në Perastti, ditën e dhetë të korrikut, në vjetë të Krishtit njimië e shtatqint e tre”. **Marrë nga “Concilli i ZÉUT 'SCCIPNIIS” Bot. III N'Rom, me sctamp T' Cuvenit S. T' PROPOGANDS, 1878 – FQ XI**

Po radhisim më poshtë ipeshkvijtë dhe etërit katolikë që nënshkruan Koncilin e Parë të Kishës Katolike të Shqipërisë, mbajtur në Merqi në vitin 1703 nën kryesinë e Shkëlqesisë së Tij, Imzot Vincenc Zmajeviq, arqipeshkëv I Tivarit:

Imzot Vincenz Zmajeviq, arqipeshkëv i Tivarit, Primat i Serbisë, Vizitator apostolik në Shqipni.
Imzot Pjeter Karagjiku, arqipeshkëv i emnuem i Shkupit.
Imzot Gjergji, Ipeshkëv i Zadrimës.
Imzot Nikollë Vladanji, ipeshkëv i Lezhës.
Imzot Ndue Babi, ipeshkëv i emnuem i Shkodrës.
Imzot Marin Gjini, ipeshkëv i zgjedhun i Pultit.
Atë Fra Egjidi de Arsenta, Prefekt Apostolik I Misioneve t'Arbënisë.
Atë Fra Frano Maria a Lycio, Prefekt Apostolik i Misioneve të Maqedonisë.
Atë Fra Martini nga Gjonima (Gjonmi), i pari I Provinçes së Fretënve.

Radio Vatikani
Shih edhe **BUZUKU 13, 2003:11,** ***Perkoliqi Pjetër:*** **Arqipeshkvi i Tivarit dhe Kuvendi i Arbënit, referimin në Ulqin para 10 viteve në gjuhën shqype të shestanasve.**

Peticion e intelektualëve kundër rishikimit të historisë nga turqit

Publikoi **moderator.lidhja_came@yahoo.com më** 27. 03. 2013.
Shkrimtarë, gazetarë, publicistë dhe kritikë nga trevat shqiptare janë bashkuar për të nënshkruar një peticion ku kërkohet që rishikimi i historisë të mos bëhet nën mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore turke.

Mes nënshkruesve është edhe shkrimtari Ismail Kadare.

Në peticion thuhet se pushtimi osman shkaktoi një gropë të zezë në historinë e kombit shqiptar.

"Ai e ndërpreu procesin normal historik të zhvillimit të kombit tonë. Ky pushtim i shkëputi me dhunë shqiptarët nga Europa dhe shkaktoi tragjedi dhe drama të pashlyeshme në kujtesën historike të kombit. Nuk mund të pajtohemi kurrë dhe dënojmë përpjekjet e disa pseudohistorianëve dhe të segmenteve të caktuara politike, të cilat përpiqen që shekujt e gjatë të pushtimit osman t'i paraqesin si kohë të bashkëjetesës paqësore dhe të suksesshme", thuhet në peticion.

"Ndryshimi i historisë në formë arbitrare, duke i ardhur rreth oreksit të diplomacisë turke, krijon një precedent të rrezikshëm: pas disa vitesh edhe Serbia mund të kërkojë të shpallet vetëm një administratore në Kosovë dhe ajo të vlerësohet pozitivisht për lirinë, pavarësinë, kulturën dhe identitetin tonë.

Të mos harrojmë faktin se nga të gjitha gjuhët e të gjithë popujve të pushtuar nga osmanët, gjuha shqipe u ndalua në mënyrë të veçantë e me forcë. Mjafton vetëm ky fakt për të treguar gjenocidin e Perandorisë osmane kundër shqiptareve, kundër kulturës dhe identitetit të tyre. Ne nuk mund t'i fshehim te vërtetat historike. Mjafton të kujtojmë përpjekjet dhe sakrificat e panumërta të Rilindësve shqiptarë për të parën shkollë shqipe laike, e cila u arrit të hapej vetëm me 7 mars 1887 në Korçë.

Ndryshimet e historisë me ekspertë turq përbëjnë një agresion kulturor që godet shtyllën kurrizore të kombit, ato janë një fyerje e papranueshme për shqiptarët dhe me pasoja për të ardhmen dhe identitetin e tyre. Të gjithë tashmë e dimë se çdo ndërhyrje në histori sipas skenarëve të paracaktuar politikë cenon ADN-në e kombit shqiptar", vijon peticioni.



LISTA E NENSHKRUESVE

Ardian Ndreca (filozof, Universiteti Urbaniana në Rome, Itali)
Anton Berishaj (kritik i letërsisë, poet, Universiteti I Prishtinës)
Akil Koci (Kompozitor, muzikolog)
Adem Gashi (shkrimtar)
Agron Tufa (shkrimtar, Universitetit i Tiranës)
Artan Shkreli (arkitekt)
Agron Gjekmarkaj (kritik i letërsisë, Universiteti I Tiranës)
Anton Gojcaj (shkrimtar)
Arian Krasniqi (dramaturg)
Arben Rugova (gazetar, publicist)
Avni Dervishi (politikolog)
Aleksandër Çipa (kryetar i Unionit të Gazetareve, poet, publicist)
Agreta Gashi (mjeke, Universiteti i Prishtinës)
Antonio Gashi (violonçelist, Universiteti i Prishtinës)
Aida Dismondy (doktorante)
Ardian Haxhaj (shkrimtar)
Afrim Krasniqi (politolog, Universiteti i Tiranës)
Arbana. F. Xharra (publiciste, gazetare)
Avni Zogiani (aktivist i shoqërisë civile, publicist)
Albert P. Nikolla (antropolog, Universiteti i Tiranës)
Aljula Jubani (albanologe, Universiteti i Tiranes)
Angjelin Shtjefni (Universiteti i Tiranës)
Arlind Dobërdolani (student)
Anila Malile (diplomate)
Adnan Mustafa (farmacist)
Alfred Duka, avokat)
Alda Bregasi (kardiologe, Universiteti i Yale)
Asllan Muharremi (përkthyes)
Beqë Cufaj (shkrimtar, publicist)
Brunilda Ternova (gazetare, përkthyese)
Bujar Kapllani (skulptor)
Begzad Baliu (albanolog, Universiteti i Prishtinës)
Bardhyl Matraxhiu (kritik, Universiteti i Tiranës)
Bardh Frangu (shkrimtar, publicist)
Behar Gjoka (shkrimtar, studiues),
Bardhyl Londo (poet, Mjeshtër i Madh)
Blerina Suta (kritike e letërsisë, Universiteti Aleksander Xhuvani)
Donika Gervalla-Schëarz (veprimtare, publiciste)
Daut Demaku (shkrimtar)
Dorian Koçi (publicist, Universiteti i Tiranës)
Durim Çaça (poet)
Eugjen Merlika (publicist, shkrimtar)
Elida Buçpapaj (poete, publiciste)
Edita Kuçi Ukaj (publiciste, përkthyese)
Entela Kasi (shkrimtare, presidente Albanian Pen Center)
Erion Hasanbelliu (inxhinier elektrik)
Franco Altimari (albanolog, zv. Rektor, Universiteti I Kalabrisë, Itali)
Femi Cakolli (kritik letrar)
Flutura Açka (shkrimtare)
Flaka Surroi (publiciste,)
Francesco Marchianò (pedagog në Spezzano Albanese Calabri)
Fahri Xharra (publicist)
Fatmir Terziu (shkrimtar, kritik arti)
Flamur Shehu (kompozitor, Mjeshtër i Madh)
Gëzim Gurga (albanolog, Universiteti I Palermos, Itali)
Giuseppina Turano (albanologe)
Gëzim Alpioni (sociolog, Universiti i Birmingham-it)
Gezim Basha (poet, përkthyes)
Gjon Berisha (historian, Instituti i Historisë)
Gjergj Filipaj (gazetar, shkrimtar)
Gjon Keka (publicist)
Gjergj Bajram Kabashi (publicist)
Halil Haxhosaj (shkrimtar, kritik letrar)
Ismail Kadare (shkrimtar)
Iris Elezi (regjisore)
Imer M. Mushkolaj (publicist)
Isak Ahmeti (albanolog, shkrimtar)
Ilire Zajmi-Rugova (shkrimtare, gazetare)
Irena Gjoni (poete)
Ismail Rugova (bibliotekar, përkthyes)
Jahja Drançolli (historian, ligjërues)
Jonila Godole (përkthyese, shkrimtare)
Kujtim M. Shala (kritik i letërsisë, Universiteti i Prishtinës)
Kole M. Berisha (ish kryetar i parlamentit të Kosovës, publicist),
Kolec Traboini (poet, kineast)
Lazer Stani (shkrimtar)
Lucia Nadin (albanologe)
Lush Culaj (historian, Instituti Albanologjik i Prishtinës)
Leonard Seiti (poet)
Ledia Dushi (poete, përkthyese)
Lis Bukuroca (Naser Aliu) (publicist)
Lediana Stillo (poete, përkthyese)
Matteo Mandalà (albanolog, Universiteti i Palermos, Itali),
Majlinda Bregasi (albanologe, Universiteti I Prishtinës)
Martin Berishaj (politikolog, Universiteti i Lublanës)
Monica Genesin (albanologe, Universiteti i Salentos – Lecce, Itali)
Maks Velo (piktor)
Mentor Quku (historian i letërsisë)
Migena Kapllani (arsimtare)
Mira Tafani (arsimtare)
Ndue Ukaj (kritik i letërsisë, shkrimtar)
Natasha Lushaj (poete, kritike letrare)
Ndue Gjika (shkrimtar)
Nexhat Latifi (biznismen)
Persida Asllani (kritike e letërsisë, Universiteti I Tiranës)
Pandeli Çina (mjek)
Preveza Abrashi (mjeke, Universiteti i Prishtinës)
Prend Buzhala (shkrimtar, kritik i letërsisë),
Petrit Palushi (shkrimtar, kritik letrar)
Peter Tase (përkthyes)
Petrit Ruka (poet, kineast)
Qibrie Demiri- Frangu (poete, Universiteti I Prishtinës)
Qazim Namani (historian)
Romeo Gurakuqi (historian, UET)
Rudolf Marku (shkrimtar)
Romeo Çollaku (shkrimtar, përkthyes)
Ragip Syla (shkrimtar)
Rita Salihu (poete, veprimtare)
Rexhep Shahu (poet, publicist).
Sali Bashota (poet, pedagog në Universitetin e Prishtinës)
Skender Zogaj (shkrimtar, publicist)
Skender Buçpapaj (publicist)
Sabit Rrustemi (poet)
Shaban Sinani (studiues dhe historian i letërsisë)
Sadik Bejko (poet)
Shaip Emerllahu (drejtor i Manifestimit "Ditët e Naimit, poet)
Shpend Bengu (Pedagog i historise se artit dhe multimedias)
Shpend Sollaku Noe (shkrimtar)
Trina Gojani (poete, përkthyese)
Uk Lushi (shkrimtar, publicist)
Visar Zhiti (poet, Mjeshtër i Madh)
Vlora Baruti (muzikante)
Virgjil Kule (publicist, studiues)
Vladimir Beja (Ish komandat i flotës)
Visar K. Berisha (mjek, Universiteti i Prishtinës)
Zenel Kelmendi (ish rektor i Universitetit të Prishtinës)
Zef Gjeta (ILB)
Xhavit Beqiri (poet, Universiteti i Prishtinës)


Xh4emal Ahmeti (kritik letrar, publicist)

Në Shas zbulohen edhe tri kisha

Shkruan mr. **Anton Lulgjuraj**, arkeolog


Kisha e Shmrisë, Shas, Ulqin

Prej burimeve historike shpesh kemi dëgjuar dhe është përfolur se në Shas kanë ekzistuar 365 kisha, aq sa ka dhe ditë në vit. Kjo legjendë si dhe shumë legjenda tjera të së kaluarës i kalojnë kufijtë logjikes njerëzore dhe kështu krijojnë mite dhe tregime të ndryshme. Por edhe ke legjendat fshihen pjesëza të se vërtetës. Siç dëshmon shprehja popullore ku ka tym ka dhe zjarr. Pra kjo legjendë na prinë ne mendimin se këtu kemi të bëjmë me një qytet me numër të madh kishash dhe kapelash. Megjithatë duke marrë parasysh numrin e banoreve dhe madhësinë e sipërfaqes të qytetit në mesjetë, ku edhe e ka zhvillimin më të madh Shasi, gjithashtu duke e krahasuar edhe me qytetet fqinje të kohës siç ishin psh: Shkodra, Ulqini, Tivari e Drishti, atëherë numri 365 i disa kronistëve na del jo real me kohën.
Nga gërmimet arkeologjike të udhëhequra nga Qendra për hulumtime Arkeologjike të Fakultetit Filozofik në Beograd viteve 1985, na japin 9 kisha, dy prej te cilave janë Katedralja e Shën Gjon pagëzuesit dhe kisha e Shën Mërisë. Këtyre ja shtojmë edhe tri kisha të reja të zbuluara nga ekspedita e fundit arkeologjike që u zhvillua në vjeshtën e vitit 2012 në qytetin e vjetër të Shasit, nën drejtimin e Muzeut Nacional të Cetinës. Po ashtu janë dy objekte të dyshimta që mund të jenë përdorur si kisha, por sidoqoftë ende këto objekte nuk japin shumë elemente arkitektonike për ti vërtetuar se kanë qenë të tilla. Të sigurta janë tri kishat deri tash të panjohura, te zbuluara në anën perëndimore të pjesës së poshtme të qytetit. Njëra prej këtyre kishave ka përmasa modeste dhe dy tjera janë kapela me përmasa të vogla. Këto duhet të jenë të shekullit IX deri në shek. XI, sipas materialit të gjendur aty pranë.
Për Shasin kristian kemi dëshmi se ka ekzistuar prej shek. VI, pastaj me vonë përmendet si peshkopatë e cila si e tillë ekzistonte deri në shek. XV, kur Shasin e poshtuan Turqit.
Pra deri me tani kemi 12, numër jo i vogël ky, nëse i marrim parasysh se si është zhvilluar jeta në mesjetë në këto treva, dhe rezultatet e deritanishme nuk janë përfundimtare, kështu që ka hapësirë mjaft të madhe që këtij numri ti shtohet edhe shumë objekte tjera të shenjta. Dhe me plot gojë mund të konstatojmë se Shasi në të kaluarën me të vërtetë ka qenë një qendër e krishtere e fortë, me jetë të pasur religjioze dhe me shumë kisha, megjithatë numri i këtyre kishave s'duhet ta kalojë numrin dyshifror.



Diskriminimi i shqiptarëve në Greqi

Në vitin 1913, kur Çamëria (Epiri) u çlirua nga Turqia dhe iu dhurua Greqisë, Çamët (popullsi shqipfolëse) numrojshin rreth 40.000 vetë. Shumë nga ata, të detyruar nga politika diskriminuese greke, u larguan për në Turqi e Egjypt. Para 1928, popullsia myslimane e Epirit ishte 20.160 banorë dhe shtrihej në 63 fshatra e qytete të ndryshme, ndërsa më 1928 popullsia myslimane e çamëve arrinte në 19.244; 17.008 vetë deklaronin si gjuhë mëmë gjuhën shqipe.... Regjistrim tjetër në Prill 1951 tregon se 22.736 grekë në gjithë Greqinë deklarojnë gjuhën shqipe si gjuhë-mëmë, nga të cilët vetëm...7.357 në rajonin e Epirit dhe vetëm....127 deklarohen myslimanë (që mund të konsiderohen çamë). Kjo rënie e numrit u shkaktua nga dëbimet masive që Greqia u bëri çamëve pas Luftës II Botërore.

Të dhëna "të panjohura" për periudhën midis dy luftërave

Me formimin e shteteve Ballkanike, në territoret e Turqisë Otomane të shkatërruar ishte e pashmangshme që shumë popullsi me kombësi, fe e gjuhë të ndryshme të ndaheshin në shtete të ndryshme. Më 1923 në Konventën e Lozanit midis Turqisë e Greqisë u vendos ndërrimi i popullsive, ku përfaqësuesi grek (Dhimitri Kakalamanos) deklaroi se "në ndërrim përjashtohen Çamët, si popullsi myslimane shqiptare". Por drejtimi kombëtar dhe vërtetimi i prejardhjes se çamëve ishin shumë të vështira në atë kohë. E trembur për këtë gjë, Shqipëria e Ahmet Zogut.... vuri në dijeni Fuqitë e Mëdha të kohës (Angli, Itali, Francë) për rrezikun e ndërrimit të Çamëve (si myslimanë) me popullsinë ortodokse që vinte nga Turqia. Ahmet Zogu arriti deri atje sa kërcënoi se do të bënte ndërrim me popullsinë greke që ndodhej në Jug të Shqipërisë. Shqipëria e shtroi çështjen në Mbledhjen e Këshillit të Shoqërisë së Kombeve me 1923 duke shtruar si çështjen e përjashtimit të Çamëve nga ky ndërrim, ashtu edhe dëmshpërblimin për tokat e pasuritë e marra nga qeveria Greke dhënë popullsisë së ardhur nga Azia e Vogël. Pala shqiptare këmbënguli që komisioni të vendos në bazë të gjuhës, meqë Çamët ishin autoktonë në trojet e tyre dhe nga që Çamët nuk mund të flasin të lirë nga frika që grekët mund t'i dëbonin.

Këtë qeveria greke e pranoi, por u përpoq qe nga 1924, me mjete të ndryshme, të shkaktojë emigrimin e tyre. Solli mijëra refugjatë ortodoksë nga Azia e Vogël e i vendosi në këtë territor. Këta refugjatë, me ndihmën e ligjit të kohës, morën pjesën më të mirë të tokës, sidomos në rajonet e Igumenicës e të Fanarit. "Shtetëzimi" (dmth, grabitja) përfshinte tokë bujqësore dhe banesa. Turqia njoftoi se do të pranonte vetëm 5.000 myslimanë të Çamërisë. Greqia e anuloi marrëveshjen me Turqinë. Në marrëveshjet greko-shqiptare që u nëneshkruan atëherë parashikohej edhe dëmshpërblimi për pasuritë e mara të Çamëve, bile me kushte të mira, por nuk e pranoi parlamenti grek. Çamët të përjashtuar edhe nga ndërrimi i popullsisë, mbeten pa shtëpi, toka e mjete jetësore. Shqipëria e ngriti përsëri çështjen në Shoqatën e Kombeve, nga ku u vendos të diskutohej përsëri midis dy palëve. Më 1931, u votua një ligj që parashikonte dhënien e dëmshpërblimeve, me letra me vlerë, dhe shpërblim të menjëhershëm për pasurinë e patundshme. Më 1933, Shqipëria pranoi përfundimisht, dhe me ligj të ri, filloi procedura. Në mesin e vitit 1935 një numër i konsiderueshëm i tyre ishte dëmshpërblyer. Por, shumë çështje mbeten të pa zgjidhura deri në shpërthimin e Luftës II Botërore.



Më 1935, komandanti i ri i Përgjithshëm i Epirit, Panajotakos, filloi masa presioni e shantazhi ndaj Çamëve. Veprimet e paligjshme ndaj tyre (arrestimet e paligjshme, kontrolli i shtëpive, rrahjet, përdhunimet, ... ndalim i përdorimit të gjuhës shqipe në vende publike, ndalimi i shtypit të çdollojshëm shqip) ishin kaq të ndjeshme, saqë edhe gazetat greke të kohës protestuan ashpër. Ministria e Jashtme udhëzon që të ndihmohen Çamët që donin të emigronin për në Turqi (t'u jipen pashaporta), kurse kredi ortodoksëve të Epirit, që të kenë mundësi të blejnë shtëpitë e Çamëve...

Lufta II Boterore: Hakmarrja e Çamëve

Në 1939, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, kontaktet e Çamëve me italianë sjellin pikëpamje fashiste e nacionaliste. Pala greke shtoi numrin e forcave ushtarake, dhe largoi burrat Çamë, nëpërmjet mobilizimit ushtarak. Shumë dezertuan, kaluan kufirin, duke u pritur nga italianet dhe formuan batalione vullnetarësh. Trupat e vullnetarëve Çamë në ushtrinë italiane, gjate kalimit në Greqi, plaçkiten e dogjën mjaft fshatra e qytete, si dhe u shënuan edhe vrasje në shenjë hakmarrje. Ushtria italiane qëndroi në Çamëri deri në Nëntor 1940.

Kthimi i pushtetit grek u shoqërua me veprime hakmarrëse, ekzekutime dhe internime të disa qindra burrave, çka zgjati deri në pushtimin gjerman në 1941. Çamët fituan përsëri një regjim lirie, me pasojë terrorizimin të popullsisë greke. Autoritetet qendrore greke ranë dakord me italianët, që një pjese e prodhimit bujqësor t'u jepej pronarëve të ligjshëm të tokave.

Hakmarrjet e vjetra, mosmarveshjet për çështjet e tokës, vjedhjet reciproke, përdhunimet, vrasjet u bënë fenomene të përditshme.

Dëbimi me dhunë i Çamëve

Forcat gjermane e braktisen Çamërinë më 1844. Reparti i Divizionit grek mori në zotërim Paramithian, çka u shoqërua me kaos, plaçkitje, përdhunime, keqtrajtime dhe therje "në shesh" të myslimanëve në qytet e rrethinë. Filloi shfarosja masive e fshatrave myslimane në Jug të lumit KALAMA. Çamët ikën drejt Shqipërisë; deri në Dhjetor 1944 kaluan kufirin 22-25.000 çamë.

Pak pas vendosjes së autoritetit grek në Çamëri, u hap një fushatë e gjerë akuzash, ndaj çamëve shqiptarë që kishin ushtruar dhunë dhe bashkë-punuar me gjermanët e italianët. Një gjykatë speciale në Janinë dënoi në mungesë 1930 persona të kombësisë çamo-shqiptare.

Disa vite më vonë dolën dekrete ligjore "për shtetëzimin e detyruar të tokave të tyre e për dhënien e tyre bujqve të patokë", "për ribanimin e rajoneve kufitare dhe ndihmën për popullsinë e kësaj zone".

Në të njëjtën periudhë që shteti grek "mbyllte" çështjen Çame, Enver Hoxha, jepte goditjen vdekjeprurëse: Në 1953 nxori dekret me të cilin jepte nënshtetësinë shqiptare të gjithë çamëve që banonin në Shqipëri. Kush e kundërshtoi këtë dekret, u internua apo u burgos.

*Pikërisht pas 50 vjetësh nga terrori mbi çamët në Paramithia -Qershor 1994- Parlamenti shqiptar përcaktoi 27 Qershorin si ditë përkujtimore të "GJENOCIDIT MBI ÇAMËT"

Marrë prej gazetës greke "Greqia Misterioze" (17.08.2012).

Ligji i Parë i historisë është, që mos të guxohet të thuhet diçka e rrejshme, pastaj mos të guxohet të heshtet e vërteta*.

*Tha papa **Leoni XIII, më 18.7.1882,** e marrë prej vlerësimit të Dr Kastriot Markut për librin e profesor Zef Mirditës: Krishtenizmi ndër shqiptarë **(f. 46)**, Drita & Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Prizren - Zagreb, 1998.

KOSTANDINI I MADH NË KONTEKSTIN DARDAN DHE DARDANI

Shkruan
Prof. dr. Jahja Drançolli*,
Fakulteti filozofik, Prishtinë

Gjatë këtij viti e tërë bota e krishterë është duke shënuar 1700-vjetorin, nga miratimi i të ashtuquajturit Edikti i Milanit më 313. Me kalimin e kësaj date, e cila konsiderohet për njërën ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së njerëzimit, të krishterët kanë mundur përfundimisht për të marrë frymë lirisht pas përndjekjeve të tmershme. Për më tepër, krishterimi nga kapërcyelli i shekullit IV shpallët për fe shtetërore në Perandorinë Romake.



Personaliteti kryesor për këtë kthesë të madhe historike konsiderohet perandori *Kostandin* (306-307; 307-337), i cili duke bërë konventë me krishterimin dhe duke hapur epokë të re në historinë botërore, me të drejtë e ka merituar epitetin i Madh, i cili u ka takuar vetëm disa personaliteteve të shquara historike.

Në gjashtë shekujt e parë të erës sonë, edhe pse administrata romake kishte sjellur procese të reja ekonomike, shoqërore, politike, fetare e kulturore, qyteti i lindjes së Kostandinit, *Naissus*, si dhe provinca e Dardanisë ku është gjendur qyteti në fjalë, sipas burimeve të kohës përfshiheshin në kuadrin e konceptit etnogjeografik "*Dardani*", respektivisht "*Iliri*". Themeluesi i dinastisë, babai i Kostandinit, *Constantius Chlorus*, ishte nga Iliriku, sikurse shkruante *Aurelii Victoris* në *Jetëshkimin e Perandorëve*: *Illyricum patria fuit*. Për vendlindjen e Kostadinit, qytetin *Naissus* shkruante *Anonymi Valesiani*. Gjithashtu, për këtë qytetet si vendlindje të Kostandinit shkruante edhe *Prisci* në *Historia Gothica* ku theksohet se Naissus ishte *qytet në Iliri*.

Origjinë dardane kishte edhe perandori ngadhnjimtar mbi gotët, Klaudi II (268-270), i cili për nga linia femërore kishte lidhje perandorake. Këtë njoftim e ndeshim në shkrimin *Vita Aureliani* në *Historia Augusta*, ku thuhet se Klaudi II ishte nip i Eutropit me origjinë nga një familja e respektuar dardane (*Eutropius*, *nobilissimus gentis Dardaniae vir*). Eutropi, siç është e njohur ka qenë babai i *Constantius Chlorus*-it. Njoftime të përafërta ndeshim edhe te panegjerikët e Kostandinit.

Duhët përkujtuar edhe fakti se në Dardani, respektivisht në Naissus sipas *Olympiodori Fragmenta*, kishte lindur edhe *Flavius Constantius*, respektivisht perandori romak Konstanci III, i cili vdiq në vitin 421. Ky ishte baba i perandorit tjetër romak, Valentianus III Flavius Placidius (425-455). Ndërkaq, në rajonin në mes të Naissus-it dhe Scupi-t rreth vitit 482 lindi njëri ndër perandorët më të mëdhenjë bizantin, Justiniani I (527-565). Ky perandor me origjinë të gjakut dardan përveç se kishte themeluar qendrën e madhe *Iusiniana Prima*.

Për shkaqe të ngatërresave të cilat bëhën me dashje dhe padashje sot e gjithë ditën në historiografi e quaj më vend të theksoj se, pjesë të Dardanisë ndeshim edhe në pjesën veriperëndimore të Azisë dhe në disa zona në jug të Gadishullit Apenin. Për Heroin eponim të tyre, Eneun, këndon Homeri në këngën njëzetë të Iliadës, të cilin e konsideron për djal të Zeusit dhe themelues të linjës mbretërore të Trojës. Përveç Eneut, si themelues i fuqisë dhe lavdisë së Romës, me origjinë dardane krenoheshin edhe shumë popuj të botës së antikitetit – Epirotët, maqedonasit dhe romakët, si dhe shumë personalitete të shquara të historisë - Julius Caesar, Oktavian Augusti, Klaudi II, dhe natyrisht Kostandini i Madh dhe Justiniani.

Ajo që tërheqë më tepër vëmendjën në këtu është se, që nga mijëvjeçari i parë para/Kr., treva e qytetit të lindjës së Kostandinit të Madh, Naissusi është përfshirë brenda një uniteti kulturor e etnik të Dardanisë, respektivisht të dardanëve të Gadishullit Ballkanik, si një nga fiset kryesore ilire. Prania e këtij etnosi në këtë hapësirë dëshmohet edhe nga historianë dhe gjeografë më të shquar të antikitetit. Këtej, *Herodoti* në veprën *Historia* zbulon se territori i Dardanisë qe pjesë përbërse e Ilirisë. Historiani romak *Apijani*, si dhe gjeografi grek *Straboni*, shkruajnë për iliricitetin e dardanëve, sikurse edhe të fiset të tjera të kësaj hapësire. *Pliniu*, ndërkaq konstatatonte se lumi Vardar ndante Dardaninë prej Maqedonisë. Ndërkaq, historiani i madh romak, *Tit Livi* shkruante për luftrat kufitare dardano-maqedonase e për inkursionet romake në Dardani. **Nga shek. II burimet lidhur me Naissusin janë gjithnjë më të shpeshta, më të plota, ndërkaq ngjarjet në qytet mund të ndiqën pa ndërprerje. Atëbotë, qyteti në fjalë ishte bërë qendër për organizimin e mbrojtjës së Dardanisë Veriore.**

Edhe kartografia e kohës antike, si, *Tabula Peutingeriana* dhe gjeografi

Ptolomeu ofrojnë të dhëna për shtrirjen gjeografike të Dardanisë, që mund të ndiqet përmes kufijve veriorë Novi Pazar-Nish, e gjithë treva e Kosovës dhe e Maqedonisë Veripërendimore me kryeqendër, Scupin. **Në këtë kuadër, ndonjë studiues ka bërë përpjekje që të përkufizonte edhe kufirin etnogjeografik të Dardanisë, kufij ky që mund të ndiqet përmes kufijëve *Perëndimor* sipas linjës së sotme Gjakovë-Pejë-Novipazar-Ivanjicë-Çaçak, e cila ishte njëkohësisht edhe kufiri i provincës. Në *Lindje* ndërkaq, kufirin e Dardanisë duhet kërkuar nga pozicioni Kumanovë-Vranje, deri në rrethet e Remesianës (Bela Palanka e sotme) te lumi Nishava. Kufiri *Verior* është shtrirë mbi rajonin e qytetit Naissus.** Në mbështetje të kësaj bën fjalë edhe një njoftim i *Ptolomeut* të përmendur më lartë, sipas të cilit, *Naissus ishte njëri ndër katër qytete të Dardanisë*, njoftim ky që pajtohet deri diku me pohimet e *Plinit*, sipas të cilit, lumejtë e njohur *Margus*, *Timachus* dhe *Pingus* rrjedhin nga Dardania **(Plin. *Naturalis Historia*, lib. III, 149: "*Flumina clara e Dardanis Margus*, *Pingus*, *Timachus*"). Ndërkaq, sipas një monumenti epigrafik ku përmendet *Dea Dardania*, të zbuluar në vendin Kamenica, në mes të Kragujevacit dhe Milanovcit të Epërm, mund të dyshohet se kufiri i Dardanisë shkon edhe më në veri nga kufiri, të cilin e përcaktonin Ptolomeu dhe Plini.**

Nga kapërcyelli i shek. III, respektivisht në vitin 297 perandori Dioklecian pasi që kishte reformuar adminsitratën romake, Dardania paraqitet si provincë në vete, provincë kjo e cila dëshmohet nga një mbishkrim i zbuluar në Romë: *[Nai]sso Darda(niae)*. Është për të vënë re se, Provinca e Dardanisë përfshinte në verilindje këto qytete: *Naissus*, *Remesiana* (Bela Palanka e sotme), *Justinopolis* (Cariçin Grad i sotëm), dhe *Serdica* (Sofia e sotme), qendra këto, të cilat do të bëhen edhe qendra kryesore administrative të Dardanisë. Për ta zbardhur sa më mirë këtë çështje lypset të ndalemi edhe në të dhëna të autorëve dhe burimeve të antikitetit të vonë dhe bizantinë.

Një gjendje e këtillë e rregullimit adminstrativ romak ka vazhduar gjatë gjithë shek. IV, por edhe pas ndarjës së Perandorisë Romake në vitin 395 dhe deri në vitin 618, vit ky i përmendur sipas *Miracula Sancti Demetri*, ku qyteti Naissus qe



përfshirë në Provincën e Dardanisë, e cila sikurse edhe provincat të tjera jugore të Ilirikut kanë hyrë në përbërjen e Perandorisë Bizantine. Gjatë kësaj kohe janë vërejtur në mjaftë vendbanime të lashta dhe të reja që kanë të bëjnë me gjallërimin e popullsisë autoktone dhe me forcimin e karakterit etnik të saj. Në këtë kontekst, duke lexuar veprën e *Hieroclis Synecdemus*, burim i rëndësishëm i shek. VI-të për njohjen e gjeografisë dhe të organizimit administrativ të Ilirikut, do të shohim se provincën e Dardanisë e kanë adminstruar tre hegjemonë të qyteteve: *Skupometropolis*, *Merion* dhe *Ulpiana*.

Organizimi kishtar

Dardania dhe dardanët e antikitetit si pjesë e civilizimit mesdhetar europian përqafuan krishterimin si fenomen religjioz e kulturor që përhapte vlera të reja të panjohura deri në atë kohë në këto hapsira.

Sipas *Ediktit të Milanit më 313*, kur organizimi kishtarë u legalizua edhe në Provincën e Dardanisë, ky religjion mori edhe frymën e zhvillimit institucional. Këtej, përmes statusit të veçantë administrativë e juridik, Dardania kishte edhe qëndren e ipeshkvisë ose mitropolinë të sanksionuar me Koncilin e Nikesë më 325. Në këtë koncil morën pjesë edhe ipeshkvijtë nga Iliriku, ne mesin e tyre përmendët edhe *Dacus Dardaniae* nga Scupi. Ndërsa sipas të dhënave të tjera, së bashku me këtë ipeshkëv ka qenë edhe ipeshkvi *Budius Stobiensis*. Në ndërkohë në periudhën gjatë viteteve 325-343 ndeshim edhe në seli të tjera ipeshkvnore, si, ajo e Ulpianës, Naissusit dhe Remesianës. Ipeshkëvi i Ulpianës (*Machedonius a Dardania de Ulpianensis*) së bashku më atë të Scupit (*Paregorius a Dardania de Scupis*), dhe të Naissusit (*Gaudentius Naissi*), kishin marrë pjesë në Koncilin e Serdikës dhe kishin nënshkruar aktet e koncilit në fjalë. Kur është fjala për ipeshkvinë e Nishit *Gaudentius* duhet theksuar se, ai është mbajtur në mend për njërin ndër të rrallët ipeshkëv deri në shekullin VI. Ndërkaq, ipeshkvi i Remisianës së Dardanisë, i quajtur Niketë Remesiana (*Niceta Remisiane civitatis episcopus*) paraqitet më vonë në vitet 366-414. Është fjala për Niketën e Dardanisë, teologun, muzikantin, shkrimtarin dhe oratorin e madh të kohës, i njohur sipas hymnit *Te Deum Laudamus*, vepër kjo, të cilën ndonjë studiues ia atribuon Shën Ambrozit.

*Pjesë nga referati i lexuar në Konferencën Shkencore kushtuar 1700-vjetorit të Ediktit të Milanos, mbajtur në Tiranë më 27 prill 2013.

PËRMENDORE E KUJTESËS HISTORIKE TË SHESTANIT DHE TË KRAJËS NË TËRËSI

Prof. Dr **Hajrullah Koliqi**, Prishtinë, 6. 6. 2013 (vlerësim) *

Këto ditë doli nga shtypi përmbledhja e punimeve të Konferencës shkencore, me titull "*Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve*", mbajtur në Ulqin më 7-8 tetor 2011, organizuar nga Shoqata "Don Gjon Buzuku" në këtë qytet, përkrahur nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, Komuna e Ulqinit etj.

Kjo vepër shkencore ka rëndësi shumëdimensionale, sepse nxjerr në dritë një spektër të gjerë vlerash, ngjarjesh dhe personalitetesh të shquara nga e kaluara e Krajës së Shkodrës, siç e quante edhe Knjaz Nikolla, para se ta pushtonte atë.

Rrënjët e popullsisë së kësaj treve arbërore shkojnë në thellësinë e shekujve të Labeatisit ilir, për të vijuar në shekujt pasues dhe të pushtimeve të njëpasnjëshme nga Perëndimi dhe nga Lindja. Krajën e cilësuan edhe "ljuta Krajina", ku shkëmbinjtë, kodrat e sukat e saj u shndërruan në kulla me frengji të kranjanëve dhe të shestanasve për mbrojtjen e trojeve të veta dhe të kufirit: në Vraninë dhe në Marksqepaj, në Bishtigvozd dhe në luftërat ballkanike (në Zogaj, Shtegvashë dhe Shkodër). Kranjanët, madje, erdhën vullnetarisht nga Stambolli për të mbrojtur vendin e vet dhe Shkodrën nga pushtuesit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Kraja pati "Urtinë" e saj, për të vijuar më pas me "Shqiponjat", me "Jehonën e Krajës" etj.

Duke iu referuar temës bosht të konferencës, në këtë përmbledhje ka kumtesa që trajtojnë aspekte dhe vlera të kulturës shpirtërore të këtyre trevave të Nënrumisë. Të njohura janë disa rite pagane, pelegrinazhi i përvitshëm në Ruminë e shenjtë, Bindi, banieri, kushti hyjnor, Shën Vladimiri dhe deri te bashkëjetesa shembullore e Pashkëve me Bajramin në këto anë. Kujtojmë se Kraja, për një kohë, kishte dy arqipeshkvi: Arqipeshkvinë e Krajës (katolike, ortodokse dhe pa sufragan) dhe Arqipeshkvinë e Tivarit, e cila për shkak të zullumit të nizamëve osman u zhvendos nga Tivari dhe u strehua në Ljare.

Në Krajë dhe në Shestan ende bashkëjetojnë tre diftongjet e shqipes: uo, ua dhe ue. Në Anën e Poshtme përdoret imperfekti sigmatik i dialektit gegë (p.sh. shkojshim, punojshim etj.), ndërsa në Anën e Sipme përdoret imperfekti sigmatik i dialektit toskë



Foto: F. Dobreci

(p.sh. shkonjim, punonjim etj.), e cila gjë dëshmon për rrënjët e përbashkëta të shqipes dhe të popullit shqiptar. Në Krajë ruhen edhe sot toponime të hershme arbërore, si p.sh. Shtegvashë, Arbnesh etj. Shqipja e shkruar ka lidhje të forta me Krajën për faktin se autori i veprës së parë në këtë gjuhë, Gjon Buzuku, konsiderohet se ishte pikërisht nga trevat e Krajës (Ljarja, Brisku apo Shestani).

Nga kumtesat e përmbledhjes në fjalë mësojmë fakte të reja edhe për personalitete të tjera të këtyre anëve, siç janë: Kont Junku apo Tahir Pashë Kranjani. Qoftë nga Kraja, qoftë me origjinë kranjane ka edhe shumë personalitete të tjera të shquara: priftërinjtë, hoxhallarë, dijetarë, deputetë dhe veprimtarë të tjerë, që jetuan dhe vepruan në trevat shqiptare ose jashtë tyre. Edhe rojet personale të Sulltan Abdylazizit, gjatë qëndrimit të tij për vizitë në Paris, më 1867, ishin pikërisht "kranjanë shtatlartë" (katolikë dhe myslimanë), të cilët i priti edhe mësuesi i rilindësve shqiptarë, Hoxha Hasan Tahsini.

Kranjanët, sidomos gratë e besimit katolik (Brisk, Ljare, Shestan etj.), ruajnë ende kostumin e hershëm të tyre. Domethënës është fakti se, si te veshja e grave të besimit katolik, ashtu edhe te ajo e grave të besimit mysliman, dominon ngjyra e bardhë. Ndër të tjera, veçojmë këtu edhe futën dhe xhamadanin e thurur me "serm të cokatun".

Kraja në tërësi është e njohur si burim baladash, këngësh lirike, epike dhe të trimërisë. Ishte e njohur si trevë e lahutës, e kavallit dhe e zumareve (zamareve). Hijeshi të veçantë i jepte vallja e Shestanit (vallja kranjane).

Kranjanët janë të njohur për virtyte të larta morale, për besë, burrëri, dorëzani, për mikpritje, për respektimin e "yrfit" të vendit etj. Kranjani e ruante me kujdes të veçantë "darkën për mikun."

Këto janë disa nga karakteristikat dhe vlerat tradicionale kranjane, por Kraja dhe Shestani ishin dhe janë edhe mjedise anomalish, politikash dhe aktesh anakronike. Kronisti e cilësoi atë "Kraja me krajata". Ja disa prej tyre: Kraja pranë ujit (liqenit të Shkodrës) ende vuan për ujë (mbijeton me ubla dhe me saranxha). Ostrosin, qendrën administrative të Krajës së Poshtme, pushteti komunist e ngriti mbi varreza qindravjeçare. Popullsia e Krajës, ndonëse tërësisht shqiptare, patronimet ende i ka të sllavizuara. Shestani tanimë i takon gjeografisë historike, sepse ai u boshatis pothuaj plotësisht nga banorët autokton. Edhe ata pak shestanas që kanë mbetur, pothuaj se janë tjetërsuar

(sllavizuar!). Ata nuk dinë ose nuk duan të dinë për gjëmën (vajtimin) dhe zinë e të parëve të tyre me rastin e vdekjes së Skënderbeut. Botën në sy ka marrë edhe shumica e popullsisë së Krajës së Poshtme. Ajo ka njërën nga shkollat më të mira në Malin e Zi, model për shkolla të tjera fillore, por me vetëm rreth 120 nxënës! Kraja ka Ruminë, por atë e serbizuan; ka gërmadhat e Kishës së Krajës, por edhe ato i uzurpuan, sikurse edhe mbetjet e objekteve të kultit në liqenin e Shkodrës etj.

Shumë prej këtyre çështjeve (temave) u rrahën në kumtesat shkencore të konferencës, më 7-8 tetor 2011 në Ulqin, përkatësisht të përmbledhjes së punimeve "*Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve*". Përgjithësisht, kumtesat në fjalë sollën prurje të reja dhe me interes, jo vetëm për Krajën dhe Shestanin, por edhe më gjerë. Ato shquhen për rigorozitet dhe korrektesë shkencore-metodologjike, për mbështetje në burime relevante, për gjuhë të pastër shqipe dhe terminologji shkencore.

Shumë prej autorëve të këtyre punimeve janë punonjës shkencorë të afirmuar dhe me kontribute shkencore shumë të rëndësishme, si: Aleksandër Stipçeviq, Aleksandar Çilikov, Zamir Tafilica, Romeo Gurakuqi, Don Nikë Ukgjini, Palokë Berisha, Nail Draga, Ruzhdi Ushaku, Shaban Sinani, Gjovalin Shkurtaj, Abdullah Zymberi, Ismail Doda, Gjokë Dabaj, Drita Halimi-Statovci, Afërdita Onuzi, Bahri Brisku, Gëzim Uruçi, Simë Dobreci, Agron Xhagolli etj.

Për suksesin e pamohueshëm të konferencës në fjalë dhe për botimin e punimeve të saj, kontribut të veçantë dha Shoqata "Don Gjon Buzuku" dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, sidomos prof. dr. Simë Dobreci, ky pinjoll shpirtëror i Gjon Buzukut, mjek në zë dhe veprimtar i përkushtuar për mbijetesën dhe ruajtjen e vlerave të të parëve të tij, të shestanasve dhe të kranjanëve në përgjithësi. Si kryeredaktor i këtij botimi, prof. dr. Simë Dobreci, me akribi dhe me përkushtim të veçantë, përgatiti dhe nxori në dritë këtë vepër dinjitoze për admirim, këtë përmendore të kujtesës historike të Shestanit dhe të Krajës në tërësi. Ky është një shembull mësimdhënës*: pak fjalë e shumë punë*, që duhet çmuar e ndjekur nga ne dhe nga brezat që vijnë.

**Lexuar më rastin e përurimit të librit organizuar nga Shoqata "Dom Gjon Buzuku" dhe Qendra Kulturore, në Ulqin më 11.6.2013.*

TË DHËNA ME PËRMASA ENCIKLOPEDIKE

Shkruan **Ismet Kallaba** (KOHA JAVORE nr 570, 13,6.2013:23)

Ulqin – Në Qendrën Kulturore – Ulqin të martën, më 11.6.2013, u përurua libri "Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve", në të cilin janë përmbledhur kumtesat nga konferenca shkencore e organizuar në Ulqin më 7-8 tetor 2013 nga Shoqata "Don Gjon Buzuku" me ndihmën e Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe Komunës së Ulqinit.

Kryeredaktori i botimit, prof. Dr. Simë Dobreci, tha se merita kryesore për këtë libër iu takon pjesëmarrësve të konferencës shkencore me referatet e tyre.

Duke sqaruar mosmarrëveshjet me kryesinë e Shoqatës "Don Gjon Buzuku" dhe përfaqësuesit e Qendrës së Studimeve Albanologjike, të cilët edhe pse organizatorë të konferencës nuk morën pjesë në përurimin e librit, ai tha se kjo lindi për shkak se "disa anëtarë të Shoqatës 'Buzuku' kërkonin që t'i bashangjiteshin këtij libri edhe disa referate që nuk ishin në program të konferencës, çka unë nuk mund ta lejoja".

Sipas tij, "kjo dhe disa kërkesa për ndryshime në fillim të librit", që për të nuk ishin normale, ishin shkaqet e mosmarrëveshjes.

"Në këtë mënyrë fillova të besoj që libri kurrë nuk do të botohet. U konsultova me disa vetë dhe vendosa ta botoj librin", u shpreh Dobreci.

Anëtari i redaksisë shkencore të librit, prof. Dr. Ruzhdi Ushaku tha se është i befasuar këndshëm me strukturën e veprës.

"Metodat apo qasja interdisiplinare e studimit të problemeve të ndryshme ka dalë si realitet edhe në këtë vepër. Këtu kemi histori, gjeografi, filologji, folklor, onomastikë, politikë, ekonomi, arkeologji etj.", u shpreh ai.

Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, anëtar i Këshillit redaktues të librit, i cili nuk ishte i pranishëm në përurim, në recensionin e tij e cilëson këtë libër si "përmendore të kujtesës historike të Shestanit dhe të Krajës në tërësi".


Foto: F. Dobreci

"Kumtesat në fjalë sollën prurje të reja dhe me interes, jo vetëm për Krajën dhe Shestanin, por edhe më gjerë. Ato shquhen për rigorozitet dhe korrektesë shkencore-metodologjike, për mbështetje në burime relevante, për gjuhë të pastër shqipe dhe terminologji shkencore", thekson ai.

Sipas Koliqit, në këtë përmbledhje ka kumtesa që trajtojnë aspekte dhe vlera të kulturës shpirtërore të këtyre trevave të Nënrumisë.

Për Dr. Nail Dragën, anëtar i Këshillit redaktues të librit, në këtë botim paraqiten të dhëna shumëdimensionale duke marrë përmasat e një enciklopedie shkencore për Krajën.


Sipas tij, botimi paraqet një kontribut me vlerë në avancimin e vlerave të përgjithshme shkencore, kulturore për këtë krahinë etnografike.

"Punimet e publikuara janë dëshmi se kemi të bëjmë me avancimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të këtij mjedisi. Madje nuk e teprojmë nëse themi se Kraja paraqet një thesar të veçantë për hulumtime shumëdimensionale e sidomos nga fusha e gjuhësisë, folklorit dhe etnologjisë", tha ai.

Vlerësime për librin dhanë edhe Ali Gjeçbritaj, Gjokë Dabaj, Prof. Dr. Abdullah Zymberi dhe Zylfije Gjoni.

Shqiptarët festojnë "100 vjetorin e pavarësisë" në Nju-Jork, kryeqytetin e Botës

Rranxa Shqyptare **Albanian Roots** Rrënjët Shqiptatre



Nuk kishte si te ndodhte ndryshe por nje festim madheshtor u mbajt më 28 nëntor 2012 ne kryeqendren e Nju Jorkut Time Square, ku me me shume se 5 mije shqiptare nga troje te ndryshme u mblodhen per te kremtuar ditelindjen e nenes tone Shqiperi. Times Square u mbulua qe ne oret e para te mengjesit me ngjyrat e flamurit kombetar Kuq e Zi duke terhequr vemendjen e miliona turisteve nga gjithe globi, nju jorkezeve si dhe mediave Amerikane. Valle,kenge, muzike dhe lot gezimi ishte 28 nentori si asnjehere me pare ne historine e shqiptareve te Amerikes. Organizata Albanian Roots- Rrenjet Shqiptare me drejtues Marko Kepi, Ervin Toro, Dori Nasto etj , ne bashkepunim me komunitetin shqiptare arriten edhe kete here vetem ne pak kohe te lene gjurme historike ne kryeqytetin e botes me nje organizim marramemdes dhe heroik.Pas manifestimit me mijera shqiptare se bashku u mblodhen deri ne oret e para te mengjesit ne ambjente te ndryshme te qytetit ku kurerezuan se bashku plot nje shekull pavarsi.

Mediat lokale gjithashtu ndoqen dhe transmetuan me interes te gjithe itenearin e Albanian Roots duke e pasqyruar Shqiperine si asnjehere me pare " Shtet Etnik" Albanian Roots –

Shkruan **Eljona Marku**
(AlbanianRoots@gmail.com;
www.AlbanianRoots.org)



Vërtetë kemi Bajram e Pashkë,
por Shqiptarinë e kemi bashkë!
(Gjergj Fishta)
Zgjodhi Fisnik S. Dobreci

Me dalë n'mé t'Rumisë



Përgatiti **Simë Gjon Dobreci**

Hadeti ka kjenë, n'Rumi me dalë njiherë n'vjetë, t'diellen, ditën e Ërrshajve (Rrëshajve, Rushajave), 7 javë mas Pashkve (simas kalendarit julian t'moçëm). Isht dashë me u nisë natën për me mrritë n'mé t'Rumisë pá zbardhë drita, ashtu qi aty, ditën e Ërrshajve, mé pritë daljen e diellit dhe Diellit me ju falë kur t'lenje, si shkruajnë Koliqi[1] dhe Tirta[2].

Ky hadet isht i moçëm disa mija vjet, i kohsë ILIRE, hadet qi u ruejtë deri tash vonë në t'gjilla venet e banueme me SHQYPTAR, thotë Tirta. Anglezja Edith Durham[3] shkruon para 100 vjetve: "kulti i diellit ishte krijuo n'Ballkan para arlljes sllave", n'ç'mënyrë vërteton se kyj hadet isht disa mija vjet i moçëm, i kohsë ilire.

N'Rumi kanë dalë t'gjill: Shestanas, Kranjan, Mikuliqas, Mërkotas, si Katoliktë ashtu elle Myslimantë e Ortodoks. Ata afër mésë Rumisë kanë luejtë valle Shestançe, kanë hjellë gurin (kush e hjell mâ larg gurin), kanë kargue (tërhjekë) konopin, si dhe lojna tjera[4,5].

N'mé t'Rumisë çdonjani çonte ka nji gur. Jo vetëm për Rrëshajë, por elle n'çdo rast t'përshtatshëm, si thotë Koliqi, kanë çue gur n'mé t'Rumisë (e naltë mi detë 1594 m). Me përhapjen e fesë kshten, n'mé t'Rumisë, kanë shkuo me kryqin e *kishsë Shmrisë Krajsë*[1] ose *kryqin e Shën Gjon Vladimirit*, si shkruan Gjura'j Macit Niks Stjeps-Dabonj (Djuro Dabović[7]).

Kryqi i Shën Gjon Vladimirit ka qinrue në kishën e Sh'Mrisë n'Kranjë. Aty pushonjshin edhe rreshtnat e Shën Gjon Vladimirit. Kryqin e Shën Gjon Vladimirit prej kishsë Sh'Mrisë e çoj me pajë Kranjanesha pej Ostrosit e martueme n'Mikuliq t'Madh (katun sipër Tivarit) n'nji familje Androviq[4], qi sot isht ortodokse[5,6]. Njani i i Androviqve ka bajtë kryqin n'mé t'Rumisë atë ditë. Kryqi pej drunit i pshtjellun me arë, isht i gjatë 45 cm, i gjânë 38 cm, i trashë 2,5 cm; n'funin e ti mâ t'ultë kâ nji top bronzit, n'cillin futnin nji shkop kur e bajshin kryqin. Mbas kryqit shkonte bajraktari i Mërkotasve. Si janë krye lojnat, t'gjillë bashkë kanë hangër drekën n'mé t'Rumisë[7]. Vebija Emrov Mujov Abazoviq (1961-) pej Peçuricet (Tivar) me tha më 20.03.2013: Kosara, e shoqja e Gjon Vladimirit, ja ka dorzue kryqin e floririt nji familjes n'Mërkot (Mrkojeviqi), e kur kta pranuen fenë islame, kryqin e mori nji familje Androviq n'Mikuliq t'Mall. Kryqi i tashem isht nji kopje i t'moçmit.

N'Kosovë, më 2 gusht, për festën Aligjini (katuni Soponica) dilet n'mé t'malit Libeten (Luboten, naltsia mi det 2496 m), qi gjinet n'prenim t'Kaçanikut (me tregoi nji plak i atij rrethi, qi u vizitue te unë n'Prishtinë).

Hadetin e ILIRVE me dalë nji ditë n'vjetë mé nji bjeshke, qi e ruojtën shqiptart, isht nji dishmi qi ILIRTË janë t'partë e SHQIPTARVE, n'çmnyrë vërtetohet, qi shqiptart n'Ballkan janë popull autokton. Pra, të gjakut ILIR janë elle t'gjill KRANJANTË, si lle t'gjill SHESTANASIT, t'gjill MALSORTË, ashtu që duhet t'burrnohena me rranxën tonë t'moçme disa mija vjet.

1.Koliqi Hajrullah, KRAJA E SHKODRËS, Art Club, Ulqin 2001:36-37.
2.Tirta Mark, Mitologjia ndër Shqiptarë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004:75-82.
3.Durham Edith, Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve, Arbëria, Tiranë 2009:144.
4.*Dishmon* Marku'j Niks Pjetrit Markut Per'Gjoks-Dedonj, Krythë, Ulqin, më 25.12.2012.
5.*Dishmon* Gjergji Leks Macit Kols Perkolonj (Perkoliq; 26.08.1926-), shestanas, Te-Pleva, Fusha e Tivarit, më 5.10.2013.
6.Më 1614 të gjitha katundet rreth Tivarit ishin katolike, përveç Mërkotit, i cili kishte elle pak ortodoks, pravosllav (*shih* Relacioni i Marian Bolicës, kotorras, për Sanxhakun e Shkodrës, më 1614 (Ljubic, Starine XII, faqe 166-193); Buzuku 14/2004:15.)
7.*Njofton* Djuro Dabovic (Gjura'j Macit Niks Stjeps-Dabonj); kopja e shkrimit është në arkivin e revistës BUZUKU.

"Vallja e Shestanit" në Podgoricë



Foto ARS - Vahid Cenaj

Në Festivalin Folklorik të fëmijëve dhe të rinjve, në Podgoricës më 22.04.2013, grupi folklorik i shoqatës "Buzuku" (Ulqin), më ftesën e organizatorit, mori pjesë me "Vallen e Shestanit". Shikuesit e pranuan më shumë interes, sepse për herë të parë nga treva shestanase u paraqit një valle shumë e vjetër, me valltarë në një veshje mbi dy mijë vjeçare të moçme, të cilën tryeza e rrumbullakët e organizuar pas shfaqjes e vlerësoi shumë lartë. Për çudi etnologët malazez konstatuan që kjo vlerë kulturore qe e pa njoftun dhe e konservuar, dhe pse më largësi gjeografike është afër Podgoricës. Tek ato ka qenë e njohur si "Valle e Cërmnicës ", më të cilën ka shumë huazime dhe ngjashmëri. Një është e sigurtë që "Vallja e Shestanit " është valle nder më të vjetrat ballkanike, kurse veshja e shestaneshës është po ajo në skulpturën të gjetur në Berat e punuar para më se dy mijë viteve. Organizatori i dha grupit një mirënjohje më çka jemi të kënaqur edhe ne. Grupi jonë fitoi ftesën për pjesëmarrjen në festivalin internacional (EVROPA JUG-LINDORE), që do të mbahet gjatë muajit maj në Gjirokastër. Shpresojmë se edhe atje do të marrim ndonjë mirënjohje apo dhuratë.

Përgatitën **Zef Lukiqi & Gjergj Pepgjoni**

Principet e përdorimin racional të antibiotikëve

Shkruan **Prim. Dr Gani Karamanaga**

Drejtimi i terapisë antimikrobike definohet si "zgjidhja optimale, dozimi dhe kohëzgjatja e terapisë me antibiotikë me rezultatin të përmirsimit klinik dhe parandalimin e infeksionit, që në mënyrë minimale të zvoglohet toksiciteti për pacientin, si edhe mundësitë minimale për zhvillimin e rezistencës të mëvonshme".

Qëllimet

Qëllimi i parë: është që në punën e mjekut në praktikën e përditëshme çdo pacient të ketë antibiotikun më të preferuar, dozën e vërtet dhe në kohë e caktuar, si dhe të jetë fare pa pasoja negative.

Qëllimi i dytë: të ndalohet përdorimi dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i antibiotikëve, si dhe keqëpërdorimet: kur mjekët shkruajnë antibiotik edhe kur nuk ka nevojë (përdorimi i antibiotikëve te infeksionet viruso-gjene), si edhe shumë herë dhënia e antibiotikëve me spektër të gjërë të cilët mbulojnë bakteriet shumfishë rezistente, te të sëmuarit ku infeksioni është nga ambienti jospitalor.

Qëllimi i tretë: zvoglimi i zhvillimit të rezistencës, për arsye se përdorimi i terapsië antimikrobike në nivel të pacientit dhe nivelit të popullatës ndryshon rregullat e rezisitencës.

Në shtatzëni preferohet mospërdorimi i tetraciklinëve, aminoglikozidve, ciprofloksacinit, të metronidazolit në doza të mëdha (2g)...

Zgjidhja e terapisë orale dhe parenterale

Në krahazim me terapinë orale, përdorimi i antibiotikëve në mënyrë paranterale ka disa mangësia, ku nënkuptohet edhe rreziku më i madhë për efektet anësore, si edhe çmimi më madhë i kësaj terapie..

Principët për përdorimin e antibiotikëve në mënyrë racionale

Të përshkruhet antibiotiku atëherë kur është mundësia t'i ndihmojë pacientit. Spektri antimikrobik i medikamentit të zgjedhur duhet të jetë ai që mbulonë agjenset patogjene të njohura, ose ato të mundëshme; mosëpërdorimi i antibiotikëve të spektrit të gjërë kur janë efikasë edhe ato të spektrit të ngusht. Duhet të mundohemi të mos të përdorohen

shumë antibiotikë për një infeksion. Aplikimi i monoterapisë preferohet vetëm në raste të vërtetuara, se terapia e kombinuar është e nevojshme dhe preferohet për efikasitetin e mjekimit si edhe mosëzhvillimit të rezistencës.

Zgjidhja e terapisë duhet të bazohet në kultivimin e agjensit bakterik dhe në rezultate të testit të ndjeshmërisë (terapia e drejtuar), ose në fakte të njohura për infeksion dhe shkakatarin patogjen (terapia empireike).

Kohëzgjatja e terapisë antimikrobike duhet me qenë sa ma e shkurtër. Gjithmonë kontrolimi të bëhet shtat ditë pas fillimit me terapi. Përdorimi i antibiotikëve në mënyrë profilaktike duhet të bazohet në të vërtetën ose të mundshmen për qëllimin që të ket ndikim në agjenset patogjene.

Vlerësimi i terapisë antimikrobike bëhet pas 48-72 orë, kur vërtetetohet përmirësimi i gjëndjesë të pacientit. Në reastet kur ka efekte pozitive terapia vazhdohet, në të kundërtën, kur nuk ka efekte, kjo do të ndryshohet.

Terapia në mënyrë orale duhet me qenë më e preferushme se ajo paranterale.Shumica e studimeve farmakoekonomik tregojnë që efikasiteti i terapisë orale është i njëjtë si ai i terapisë parenterale, kurse shpenzimet te kjo e dyta janë deri pesë herë më të mëdha.



Eskulapi (Aesculapius), perendia mitike e mjekësisë është me emër ILIR, vërteton Aleksandar Stipçeviqi, akademik i Kroacisë, ilirolog me famë botërore (përgaditi S.Gj.D.).

Thesar për njeriun është shëndeti, mandej bukuria.
(Platoni, 432-347 para Krishtit)

*

Shpirti i fuqishëm shpëton trupin e dobët.
(Hipokrati, 535-479 para Krishtit)

*

Sëmundja e bën të këndshëm shëndetin, uria – ngopjen, lodhja – pushimin.
(Herakliti, 535-479 para Krishtit)

Mjeku e këshillon të birin*

Bir i dashur, nëse e do aq natyrën njerëzore kurdo që i afrohesh studioje, nëse nuk frikësohesh prej kundërmimit të kufomave dhe prej ankesave për vuajtjet dhe nëse nuk neveritesh prej plagëve dhe varrava;

I dashur bir, nëse nuk të vjen rëndë të mos kesh asnjëherë e asnjë çast liri të plotë, nëse nuk të hidhëron mosmirënjohja njerëzore, nëse nuk rrëqethesh nga paturpësia e kokëtra-shëve, nëse nuk frikësohesh nga mendimi që përgjegjësinë për vuajtjet e huaja ta ngarkosh mbi kurrizin tënd;

Biri im, nëse nuk të vjen keq që të thërrasin vetëm kur të kenë nevojë për ty dhe të harrojnë menjëherë mbas kësaj, për shkak të neverisë së shumicës ndaj profesionit tënd;


Nëse pyetjes së parë mund t'i përgjigjesh qetas me *po*, të tjerave po ashtu qetas me *jo*, atëherë merr guximin dhe studio mjekësinë.

**Pjesë e letrës, që ia dërgoi të birit vet* Paolo Mantegazza (1831-1910), mjek italian i njohur, patolog, higjienist, antropolog dhe arsimues shëndetësor i popullit (*E përgatiti* prof. Dr Mentor Disha, Prishtinë - Dibër).

Shkolla shqipe në Zllakuqan - 115 vjetori

Shkruan **Mikel GOJANI**

Shkolla fillore "Atë Shtjefën Gjeçovi" në Zllakuqan të Klinës shënoi 115-vjetorin e punës së


Shtjefën Gjeçovi (1874-1929)

edukativo-arsimore, të cilën më 1897 e themeloi Atë Shtjefën Gjeçovi, frati, studiuesi, arkeologu dhe atdhetari, i cili mbetet ndër figurat më të njohura të arsimit shqip, të kulturës dhe atdhetarizmit shqiptar.

Një rrugëtim i gjatë shkronjash

Në këtë përvjetor, mësuesit, nxënësit dhe banorët e Zllakuqanit dhe të Lugut të Drinit përkujtojnë dhe nderojnë udhëtimin e gjatë, të vështirë, përplot me vuajtje dhe sakrifica të shumë brezave shkollarësh që kaluan nëpër këtë vatër të diturisë. Ishin ato vite e dekada të stuhishme, por gjithsesi të lavdishme, të dinjitetshme dhe krenare.

Rruga historike e shkollës sonë është rrugë e sakrificës së madhe të shqiptarëve për të zgjuar vetëdijen kombëtare. Është rruga e mbushur përplot me tendenca antishqiptare të pushteteve, me ndjekje, masa represive, me kërcënime politike dhe viktima.

Shumë etër të fesë dhe të arsimit u flijuan për binomin fe dhe atdhe

Nuk mund të mos i përmend emrat e atyre që janë vrarë për këto ideale. Në radhë të parë themeluesin e kësaj shkolle, Atë Shtjefën Gjeçovin, pastaj atë Engjëll Palajn, Atë Luigj Palajn, Atë Lorenc Mazrrekajn, Atë Marjan Prelën, Atë Klement Mirajn e të tjerë, të cilëve sot i kujtojmë me nderim.

Këtë shkollë e çeli më 1897 Atë Shtjefën Gjeçovi", në qelën e kishës për fëmijët shqiptarë pa dallim feje, ku mësohej si mbas programeve dhe teksteve të Shkollës së Korçës.

Më 1916, administrata austro-hungareze e asaj kohe e çel përsëri shkollën, ku punoi mësuesi Ndue Kolë Vorfi. Shkolla u mbyll në vitin 1919, mbas okupimit serb të Kosovës.

Më 1941, shkolla prapë e filloi punën me mësuesin e dërguar nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, Ndrecë Ndue Gjokën, i cili për tre vjet mësoi nxënësit e Lugut të Drinit.

Rrugën e mësuesit Ndrecë në këtë shkollë e ndoqën edhe shumë të tjerë.

Vite të stuhishme, por edhe rezistuese

Gjatë viteve '50-ta, '60-ta e '70- ta, edhe përkundër shumë vështirësive u ruajt tradita e arsimit e kësaj shkolle. Edhe gjatë viteve 1981-1990, regjimi serb bën shumë padrejtësi. Gjatë kësaj kohe, përveç që u shndërrua në një vatër të fuqishme të arsimit shqip, shkolla u bë edhe çerdhe e rezistencës kombëtare. Maltretimeve, diferencimeve, arrestimeve dhe burgosjeve iu nënshtruan shumë mësimdhënës të kësaj shkolle, por kurrë nuk iu gjunjëzuan pushtuesit serb.

Shkolla e Zllakuqanit, ashtu si edhe shkolla shqipe në përgjithësi në Kosovë, e vazhdoi punën edhe pas largimit të mësimdhënësve nga procesi mësimor. Kështu, nga viti 1991, me gjithë sakrificat e mëdha të kohës si ato financiare, të sigurisë së nxënësve e sidomos sigurisë së personelit mësimdhënës, mësimi vazhdoi në rrethana tjera, i ndarë nga procesi shtetëror i atëhershëm dhe i organizuar përmes vetë financimit. Gjatë këtyre viteve, mësimdhënësit për ditë provokoheshin, merren nëpër biseda "informative" dhe keqtrajtoheshin.

Në vitin 1998/99, me fillimin e rezistencës së armatosur, të prirë nga UÇK, ish nxënës të kësaj shkolle u rreshtuan në radhët e UÇK-së dhe me armë në dorë i dolën zot atdheut. Me këtë rast, për idealin e lirisë në altarin e kombit ra, dëshmori Kolë Ndrecë Mirdita, të cilin me respekt dhe krenari do të kujtojmë për jetë e mot.

Perspektivë e re

Liria e shumëpritur në Kosovë hapi perspektivë të re për shkollën shqipe dhe shqiptarët, si dhe për shkollën e Zllakuqanit, ku mësuesit dhe nxënësit do të arrijnë edhe rezultate më të mira.

Shkolla fillore ,,Atë Shtjefën Gjeçovi" në Zllakuqan, me gjithë paralelen e ndarë në Leskoc ka afër 500 nxënës, si dhe mbi 30 mësimdhënës, të cilët me përkushtim e kryejnë punën e vet.

Zllakuqan, më 15.10.2012.



Shpërngulja prej Kosovës për Turqi

Shkruan **Shqipe Berisha**

Shpërngulja e Shqiptarëve më dhunë nga trojet e tyre për në Turqi prej vitit 1912-1915; faktet janë tronditëse.

Sipas dokumenteve që gjenden në Arkivin e Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme në Beograd, në Fondin PO (Politçko Odelenje) nga **Konsulati gjeneral** jepen këto të dhëna për shpërnguljen e shqiptarëve nëpër Selanik për në Turqi.

Dokumenti nr 1246, 12 prill 1914

Koha		Numri
Nëntor	1912	8866
Dhjetor	1912	11493
Janar	1913	12087
Shkurt	1913	1288
Mars	1913	7553
Prill	1913	6725
Maj	1913	12813
Qershor	1913	9386
Korrik	1913	21045
Gusht	1913	29312
Shtator	1913	13380
Tetor	1913	14764
Nëntor	1913	17313
Dhjetor	1913	15502
Janar	1914	10182
Shkurt	1914	25060
Mars	1914	12346
Gjithsej		**239.807**

Në këtë numër të shqiptarëve të shpërngulur për në Turqi, theksohet se nuk hyjnë fëmijët që ishin nën moshën 6 vjeçare. Gjithashtu, theksohet në këto dokumente, se nëpër Kavallë kanë kaluar edhe 4000 familje myslimane, por edhe po aq përmes rrugës tokësore.

Drejtësi për Gjenocidin sllavo-serb ndaj Shqiptarve
1870 -Sanxhak





Të gjithë këta persona thuhet se i kanë çuar në Turqi me 395 anije evropiane. Sipas të dhënave të "Komitetit të Kosovës", gjatë Prillit të vitit 1914 për në Turqi janë shpërngulur: 6520 shqiptarë.

Prill	1914	6520
Maj	1914	15414
Qershor	1914	14821
Korrik	1914	26237
Gjithsej		**62.992**

Kur i bashkojmë numrin e sipërm (**239.807**) dhe atë poshtë (**62.992**), po na del, që për këtë periudhë kohore me dhunë prej Kosovës u shpërngulen **302.799** Shqiptarë. Të gjitha këto të dhëna i ka botuar Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, seksioni i Shkencave Historike ("Dokumenta o spolnjoj politici kraljevine Srbije", K.VII Sv.1 Beograd 1980.f.617-618). Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të brendshme të mbretërisë serbe (1912-1915) në Kosovë ishte planifikuar të kolonizohen 20 mijë serbë në zonën e okupuar nga serbët dhe 5 mijë malazezë në zonën e Kosovës të okupuar nga malazezët. *(Interneti 16.07.2012)*

Lugina e Preshevës proteston

Publikuan **A.Rada, M.Alla**, në **Shekulli** *Online*, më 14.11.2012

PRESHEVË - Nën organizim të Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Preshevë, aktivistët e të drejtave të njeriut po vazhdojnë festën e tyre me moton "100 Vjet Shtet -100 Vjet Harresë". Në Bujanoc e Preshevë ata kanë paraqitur "Librin e Qytetarëve", ku qytetarë të ndryshëm, figura politike, gazetarë, profesorë, mjekë e qytetarë të zakonshëm të këtyre trevave po shkruajnë urime, kritika e kërkesa shtetit shqiptar, i cili, sipas tyre, ka harruar Luginën e Preshevës.

"Jemi Një", "Kryeministër[1], ke dëgjuar për Bujanocin", "Pse s'na vizitoni? Jemi Shqiptarë", "Ne jemi mirë, kur Shqipëria bëhet mirë", "Edi[2] erdhi, po JU? ". "Shqipëri KU JE?" ishin disa nga qindra kërkesat e qytetarëve shqiptarë, të indinjuar nga politika qeverisëse e shtetit amë në këto 100 Vjet Pavarësi, e veçanërisht 20 vitet e fundit të pluralizmit politik në Shqipëri. Aktiviteti do të vazhdojë përgjatë kësaj jave, deri kur në fund organizatori të gjitha këto t'i dërgojë në mënyrë zyrtare përfaqësuesit të Shtetit Shqiptar, në këtë rast Sali Berishës si Kryeministër dhe Bujar Nishanit si President i Shtetit.

Qytetarët e zakonshëm, të pandikuar nga 'rrjetat' politike vendore kanë falënderuar aktivistët e rinj për mundësinë, që u dhanë qytetarëve për kontakte të drejtpërdrejta me krerët e shtetit, mbase kjo duke shprehur indinjatat edhe me liderët vendas, të cilët, sipas tyre, nuk dallohen nga politika që sot udhëheq Republikën e Shqipërisë.

Enkel Rexhepi, aktivist i KDNJ's lidhur me fushatën thekson: "Duke parë dhe nga afër gjendjen aktuale sociale-ekonomike, diskriminimin që u behet qytetarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës nga vet shteti ku jetojmë, Serbia, njëkohësisht duke ditur dhe çfarë bën shteti amë, Shqipëria përgjatë këtyre 100 vjetëve, vendosëm në mënyrë modeste të ngrehim zërin, që cilado qeveri qoftë, e majtë apo e djathtë të zbatojë Kushtetutën, e cila në nenin 8 të saj paraqet që Shteti Shqiptar mbron të drejtat e shqiptarëve edhe jashtë kufirit administrativ."

Në fletushkat e aktivistëve, të cilat po shpërndahen në qytetin e Bujanocit e Preshevës, është paraqitur Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili thotë: "Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, që jeton jashtë kufijve të saj. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë, që jetojnë e punojnë jashtë shtetit, për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare".

1.Sali Berisha, 2.Edi Rama

Qesh e njesh

Me Dr Mihajlo Nikoliqin, prej Vinoraçës, rrethi i Kraljevos, shoqnoheshim shpesh gjatë studimeve në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Si hokaxhi i madh që ishte, ai me pat thanë: A di si jena na Serbët. Serbi e lutte Zotin me i qorrue sytë Bugarit, popullit kojshi. Kur ia mërziti me lutje, Zoti i tha: *Po ia qorroj sytë Bugarit, nji kjothtë qi po pranon me t'i qorrue edhe ty.* Serbi u përgjegj: *Po, pranoj të me qorroni edhe mue.* (I kujtohet Simë Gjon Dobrecit)

Dita e mësuesit u festua

Shkruan **Ismet Kallaba**

Për të pestin vit me radhë, Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi ka organizuar kremtimin e 7 Marsit 2013 – Ditës së Mësuesit, me manifestim të mbajtur në Qendrën Kulturore në Ulqin.

Festimin e zbukuruan shkrimtarët Asllan Bisha, Zef Gjuravçaj, Ibrahim Berjashi dhe Haxhi Shabani; recituasit e "Të thella rrënjët i kemi", nxënësit: Mbresa Kurti, Edis Luka, Anida Kollari dhe Jasmina Gjençiqi; këngëtarët Armend Milla, Dino Zhugjeli dhe Jozefina Simoni; vogëlushët këngëtarë Niki Mjeda e Lorença Preçi, dhe David Dreshaj; Shkolla e Vallëzimit "Porta di Danza" dhe Shoqëria "Tradita" nga Ana e Malit (kënduan Elira Kovaçi dhe Egzona Salaj).


Foto: ARB

Pas intonimit të himnit kombëtar nga Gjylije Pelinku, pjesëmarrësit i ka përshëndetur kryetari i KNSH-së, Tahir Tahiri. Tha, se ju mësuesve u nderojmë për punën e madhe në shkollimin e fëmijëve në gjuhën shqipe të nanave tona. Ai përkujtoi se shumë mësues u persekutuan gjatë regjimit i atëhershëm komunist. Ndër shqiptarë në Mal të Zi, kjo ditë u lejua të festohet pas viteve '90. Sipas tij, në arsimin shqip në Mal të Zi janë bërë përparime, por ka edhe shumë probleme. KNSH i është drejtuar Ministrisë së Arsimit në Mal të Zi më 2011 me 14 kërkesa, për përmirësimin e gjendjes në arsimin shqip, por deri tani nuk ka përgjigje. Tahiri u ka bërë thirrje politikanëve shqiptarë që me rastin e takimeve të ndryshme me zyrtarë të qeverisë së Malit të Zi të kihet parasysh zgjidhja e problemeve të arsimit shqip në Malin e Zi.

Për historikun e shkollës shqipe ka folur prof. Murat Gecaj nga Shoqata e Arsimtarëve të Shqipërisë.

Fitues të konkursit figurativ ishin nxënësit Delfina Sukaliq, Gjovana Makoviq, Mesida Taganoviq, Blinera Popoviq dhe Suela Katana.

Përurohet monografia „Shkolla në Krajë 1929-2009“


Të mërkurën, më 6.03.2013 në Shtëpinë e Kulturës në Ostros, Krajë, u bë përurimi i librit „Shkolla në Krajë 1929-2009“ i



autorit Ali Gjeçbritaj. Për librin ka folur recensenti dr. Bahri Brisku, autori i librit dhe botuesi, Gazmend Çitaku nga Asociacioni „Ulqini“. Po ashtu është lexuar fjala e recensentit tjetër të librit, Fadil Kraja. Në libër autori ofron dëshmi dhe të dhëna shumë interesante mbi fillet dhe zhvillimin e arsimit në Krajë. Me këtë rast, autori ka ndarë libra për të gjitha shkollat shqipe në Malin e Zi. Përurimi është organizuar nga Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi në kuadër të aktiviteteve me rastin e Ditës së Mësuesit.
Shkruan **Ismet Kallaba**

Përurohet libri kushtuar atdhetarit Petro Nini Luarasi

Në kuadër të veprimtarive kushtuar 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Ulqinit, organizoi të enjten më 6 mars 2013, përurimin e librit "Petro Nini Luarasi - Mendimtari martir i Rilindjes Kombëtare: 1865-1911 - jetëshkrimi, studime, vepra" të autorit Alfred Uçi nga Tirana.



Për librin folën Dr. Nail Draga, profesor Murat Gecaj nga Tirana dhe vet autori. Me këtë rast, autori tha se do t'u dhurojë të gjitha shkollave shqipe në Malin e Zi nga një numër të konsideruar të librit për Petro Ninin Luarasin, në mënyrë që edhe shqiptarët në Malin e Zi të njihen më mirë me këtë figurë të ndritur të kombit shqiptar.

Shkruan **Ismet Kallaba**

Bahri Brisku na dha edhe një libër

Shkruan **Ismet Kallaba**

Qendra Kulturore (Biblioteka) në Ulqin, në bashkëpunim me disa organizata joqeveritare që merren me letrare, i cili në veprat e tij rikrijoi dhe plotësoi etninë shqiptare jo vetëm në trekëndëshin Ulqin – Shestan – Bregu i Bunës, por në tërë hapësirën shqiptare në Mal të Zi dhe më gjerë.


Foto: G. Çitaku

kulturë, organizuan të enjten, më 14.3.2013, kremtimin e 80-vjetorit të studiuesit, mësuesit, gazetarit, publicistit dhe atdhetarit Dr. Bahri Brisku, me ç'rast u përurua libri i tij "Këngë popullore të shqiptarëve në Mal të Zi", i botuar së fundi nga Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club".

Për figurën e Briskut folën Prof. Dr. Ruzhdi Ushaku, Dr. Nail Draga, Ali Salaj, Gjekë Gjonaj, ndërsa moderatorja e kësaj veprimtarie, Ardita Rama, udhëheqëse e Bibliotekës së Ulqinit, lexoi biografinë e tij.

Drejtori i Qendrës Kulturore të Ulqinit, dr. Nail Draga, tha për Bahri Briskun, që ai paraqet sinonim të momenteve të vështira që kanë kaluar shqiptarët në Mal të Zi në të kaluarën, dhe, të gjithë ata që në të ardhmen do të trajtojnë problemet e shqiptarëve në Mal të Zi, ndjekjet nga pushteti monist, montimet politike, burgosjet dhe dënimet, do ta marrin Bahriun si protagonist dhe sinonim të këtyre momenteve të vështira për shqiptarët në Mal të Zi.

Kryetari i SHAI "Art Club", Ali Salaj, ka thënë se Bahri Brisku është një njohës i mirë i letërsisë popullore dhe etnografisë, por edhe i fushave të tjera

Duke folur për vlerat e tij patriotike, Salaj tha se Brisku "luftën e tij të guximshme e nisi që në vitet '60 duke u bërë shembëlltyrë e gjeneratave të tëra dhe duke mbetur intelektual me vizion të qartë, paraprijës dhe tepër i popullarizuar në të gjitha trevat shqiptare".

Prof. Dr. Ruzhdi Ushaku ka evokuar kujtimet e tij nga jeta dhe veprimtaria e Briskut.

Ai e ka vlerësuar Briskun si "prijës që na ka dhënë edhe vullnet, edhe jetë që ta duam vendin, kulturën, librin etj."

Lidhur me librin e tij "Këngë popullore të shqiptarëve në Mal të Zi", Ushaku ka thënë se "kjo vepër, e cila përfshin një thesar aq të madh dhe të rëndësishëm të krijimtarisë gojore të shqiptarëve në Malin e Zi flet vetë për një punë shumë të rëndësishme me peshë të madhe jo vetëm për kulturën shqiptare në Malin e Zi, por edhe për kulturën mbarëshqiptare".

Publicisti Gjekë Gjonaj ka thënë se me veprimtarinë e tij krijuese shkencore dhe atdhetare, Bahri Brisku mbetet pa dyshim një figurë e nderuar dhe e rëndësishme e kulturës shqiptare. Sipas tij, Brisku ka lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në fushën e gazetarisë, detarisë së Ulqinit, mbledhjes së kulturës popullore, në fushën e krijimtarisë artistike e gojore, si dhe e ka kryer detyrën e shenjtë në shërbim të kombit dhe atdheut të vet.

Në fjalën e tij, dr. Bahri Brisku ka falënderuar pjesëmarrësit në veprimtarinë kushtuar 80-vjetorit të tij. Ai ka treguar se si gjatë periudhës para viteve '90 ka qenë e vështirë të botohen libra, qoftë edhe me përmbajtje folkloristike, për shkak të regjimit të kohës.




Foto: G. Çitaku

Rrëfim i birit Ulqin

Shkruan **Flutur Mustafa**

Mirëmbrëma Nënë … kërkoj ndjesë që po të shqetësoj kaq vonë, por ti gjithmonë më ke thënë se kur të më shterojnë fuqitë të trokas në derën tënde e ti do me dëgjosh . . .

Më di kush jam? Më njeh?

Nënë, jam Ulqini yt. Jam Ulqini 2000 vjeçar, krenar që jam i biri i Shqipërisë. Në Berlin me larguan nga gjiri yt, sa kisha mësuar të hidhja hapat e parë. Shkela në dërrasë të kalbur, kisha pas lindë në orë të ligë. Nëna, hapma derën, e di se po më dëgjon. Mund ta ndjej vajin tënd. Jam akoma biri yt, apo jo?! Po ulem këtu në prag të derës, e atyre që nuk e dinë po ua rrëfej historinë time. Po edhe atyre që e dinë, dua t'ua kujtoj se e kanë harruar. Çdo natë e kam ëndërruar se për ditëlindjen e njëqindtë të Nënës sime, do jem në prehrin e saj, çdo mëngjes kam shpresuar se kur do zgjohesha, Nëna ime, buzëqeshja e saj do ishte gjëja e parë që do shihja. Tërë këtë jetë e çova duke ngrënë thërrimet që linin të tjerët, me ëndje kujtoja qumështin e gjirit tënd e me iluzione ngopesha, ngopem edhe sot, ai iluzion ma mban frymën gjallë. Jam veshur me gjurmët e këmbëve të huaja që shkelnin mbi shpinën time, mbrëmjeve jam mbuluar me kujtimin e Nënës e krenar në breg të detit qëndrova. Numëroja yjet e çdonjërin me bukurinë tënde e krahasoja. Aq shumë të lëvdoja saqë Hëna filloi të të xhelozonte. Nënë, si biri yt, gjithmonë fola Shqip dhe kurrë nuk e mohova Flamurin tënd. U rrita jetim, e fëmijët e mi, kurrë nuk e njohën gjyshen e tyre. I rrita bijtë e mi në frymën e Shqiptarizmit, i pagëzova me emrin Shqiptar por nuk e di ku gabova. Disa po më injorojnë, disa të tjerë me flasin me tjetër gjuhë, po përkrahin disa pseudo-patriotë e fjalët e mia po bien në vesh të shurdhët. Më fal për lotët, po mundohem të bëhem burrë ashtu siç ti me ke mësuar, por s'po mundem dot. Më kanë thënë se kur do vdes do më mbështjellin me një leckë të vjetër, të kuqe me thanë, të qëndisur me ar, Bunës time blu do ia



veshin një fustan të kaltër të zbehtë, mbi varrin tim do mbjellin gjemba të bardhë e si gotë të fundit do pi nga një vere e kuqe e prishur. Rojë kockave do iu bëjë një shpend i bardhë që tërë jetën ma ka ngrënë mishin. Është i bardhë por nuk është pëllumb. E di sepse pëllumbat rriten vetëm në prehrin tënd. Ja pse nuk dua të vdes. Dua të jetoj, ta shoh fytyrën tënde, të buzëqesh në prehrin tënd, përsëri si atëherë kur isha fëmijë.

Po çmendem nga malli për vëllezërit e motrat e mia, veçanërisht për motrën time të madhe, Shkodrën, e cila akoma sot qan për vëllanë e vogël. Ka disa vite që takohemi por vetëm kaq, një takim disa orësh dhe duhet të kthehem. Ai kufi po me bren çdo ditë e më shumë. Nënë, kurrë nuk të kam pyetur pse Fuqitë e Mëdha me larguan nga ti. E di që as ti nuk e di por prapë po mundohem ta gjej një përgjigje sado absurde qofte. Unë jam Ulqini, ujku i detit, trim. Burrërinë e kam marre nga Skënderbeu, fuqinë nga krahu i Mujit, Zemërbardhësinë nga Ibrahim RUGOVA, me këtë emër me pagëzoi ILIRIA, stërgjyshja ime.

Momentalisht i pastrehë, jetim . . . bijtë e mi po me braktisin dalëngadalë gjithë secili, pasuria po i verbon, zemrën shqiptare po e kaplon errësira. Gjuhën ende e flas, por nuk e di edhe për sa … Nënë, po mendoja si ndihesh pa mua dhe vëllezërit e mi në këtë shekull? A të mungon Kosova, Shkupi, Tetova, Gostivari, a të mungoj unë Ulqini, Tivari, Plava e Gucia, me thuaj Nënë a të mungon Çamëria? Mos qaj Nënë, mua me ke sa afër aq dhe larg, me mendjen gjithmonë tek ti. Ti me mbush me shpresë e gjuha shqipe me jep jete, energji. Në çdo fjalë betohem për emrin tënd që kur ti me dhe jetë e me pagëzove me këtë emër.

- Dua ta jetoj ëndrrën time e atë ëndërr dua ta bej realitet e në sytë e botës të them jam Shqiptar e krenar. Në sytë e Armiqve të qesh e ulërij se vendin tim, tokën time, Flamurin e gjuhën s'ma merr njeri, Unë linda bir i Shqipes e i tille do vdes. "Rreth Flamurit të përbashkuar me një dëshire dhe një qëllim, të gjithë atje duke u betuar ta lidhim besën për shpëtim. Zoti vet e tha me goje, se kombet shuhen përmbi dhe, por Shqipëria do të rrojë se për te luftojmë ne."

Mërgimtarët nga Amerika ndihmuan Shtëpinë e Shëndetit në Ulqin

Shkruan **Palë Marnikoviq**

Shtëpia e shëndetit në Ulqin para afro katër muajsh bëhet me një autoambulancë të re me të gjitha pajisjet e sofistikuara që duhet t'i ketë. Ajo tashmë është pronë e shtëpisë së shëndetit dhe në shërbim të pacientëve të Komunës së Ulqinit. Vlera e këtij automjeti është 17.500 euro, kurse donatorë janë mërgimtarët tanë në Shtete të Bashkuara të Amerikës. Aksionin e inicuar nga unë për blerjen e kësaj autoambulance e kanë mbështetur shokët e mi Mark Gjokaj, Fran Çotaj, Zef Gjokaj, Zenel Xhaferoviq, Zef Dobreci nga Nju-Jorku dhe shumë të tjerë. Ata për këtë qëllim kanë grumbulluar 13.070 dollarë amerikanë. Këtë nismë, përveç vullnetarëve bamirës dhe humanistëve të përmendur, e kanë përkrahur edhe Shoqata "Dom Gjon Buzku" në Çikago, e cila na ka dhuruar 14.990 dollarë, prej të cilave Shoqata Islamike Shqiptare në Çikago ka dhuruar 2.000 dollarë.

Për mua si drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Ulqin kjo dhuratë ka domethënie të madhe dhe e vlerësoj si vepër njerëzore. Për qytetin e Ulqinit dhe për mua dita e ardhjes së kësaj autoambulance në institucionin shëndetësor që e udhëheq unë ishte një ditë e madhe. U gëzuam të gjithë, jo vetëm kolegët e mi me mantela të bardhë por edhe qytetarët e kësaj komunë. Ky donacion i mërgimtarëve shqiptarë ishte i mirëseardhur për të gjithë, aq më tepër kur kihej parasysh mungesa e automjeteve të reja në parkun vozitës të shtëpisë tonë të shëndetit. Kjo dhuratë ka qenë më se e nevojshme për këtë institucion shëndetësor dhe nuk është e para që na kanë dhuruar mërgimtarët tanë nga Amerika, të cilët me këto donacione po dëshmojnë dashurinë ndaj vendlindjes dhe bashkëvendasve të tyre. Kemi pasur probleme të vazhdueshme pasi automjetet me të cilat kemi disponuar kanë qenë të vjetra. Tani autoambulanca e re do ta zbusë atë problem dhe jemi më të qetë. Sepse ajo na mundëson transportin komod dhe të sigurt të pacientëve të sëmurë jo vetëm brenda komunës së Ulqinit, por edhe jashtë saj në të gjitha qendrat spitalore në Mal të Zi, pa e rrezikuar jetën e tyre.

Dua të shtoj se me paratë e mbetura nga donacioni i mërgimtarëve, pas blerjes së autoambulancës së re, kemi blerë edhe dy EKG-aparate, tre inhalatorë dhe një OK-puls oksimetër me vlerë prej 3.264 euro, me të cilët kemi përmirësuar nivelin e shërbimit shëndetësor në të mirë të pacientëve.

Në emër tim personal, në emër të punësuarve në Shtëpinë e Shëndetit në Ulqin dhe në emrin e qytetarëve të Komunës së Ulqinit dëshiroj t'i falënderoj publikisht nga zemra.

Ju përshëndes përzemërsisht dhe uroj që të keni fat e shëndet në jetë! Zoti i shpërbleftë gjithë ata që ndihmuan Shtëpinë e Shëndetit në Ulqin!

DONATORËT

A. New York

1.Mark Gjokaj, $500.
2.Zef Gjokaj, $500.
3.Fran Gjokaj, $500.
4.Fran Çotaj, $500.
5.Pal Çotaj, $500.
6.Xhemal Djekovic, $500.
7.Zenel Xhaferovic, $500.
8.Lubo Pekic, $500.
9.Zef Dobrecovic, $400.
10.Jeffrey Golub Evans, $300.
11.Luigj Shrkeli (Louis Overseas Travel Agency) , $300.
12.Ejll Zagreda, $300.
13.Tony Gazivoda, $300.
14.Augustin Çotaj, $200.
15.Xhemal Kollari, $200.
16.Pjeter Kolovic, $200.
17.Zef Kërrmiqi, $200.
18.Stjepë Kërrmiqi, $200.
19.Pjetër Margjonoviqi, $200.
20.Zef Markoviqi, $200.
21.Gjon Markoviqi, $200.
22.Noc Mirdita, $200.
23.Mark Mirdita, $200.
24.Branko Pekiqi, $200.
25.Avni Veliqi, $200.
26.Rrok Zadrima, $200.
27.Ahmet Zeka, $200.
28.Tom D. Shkreli, $200.
29.Mark Berishaj, $150.
30.Lek Çotaj, $150.
31.Sander Çotaj, $150.
32.Shefki Sefa, $150.
33.Mati Jankoviqi, $150.
34/Leonard Berishaj, $100.
35.Anton Bogaj, $100.
36.Andri Brisku, $100.
37.Hil Çataliqi, $100.
38.Kol Çotaj, $100.
39.Vijeko Çotaj, $100.
40.Dod Curanaj, $100.
41.Tom Prela Dedivanoviq, $100.
42.Gjergj Nikolla Dedivanaj,$100.
43.Prenç Deloviq, $100.
44.Lazer Gazivoda, $100.
45.Arjan Gjyshi, $100.
46.Alfred Jaku, $100.
47.Vinko Jankoviqi, $100.
48.Nikoll Junçaj, $100.
49.Rrok Junçaj, $100.
50.Luka Hills Koçoviq, $100.
51.Pal Kërrmiqi, $100.
52.Tom Kërrmiqi, $100.
53.Palë Lukiqi, $100.
54.Lek Djerdj Malsori, $100.
55.Nail S. Kovaçi, $100.
56.Axhi S. Kovaçi, $100.
57.Gjergj Markaj, $100.
58.Gjergj Paloka, $100.
59.Palok Rudaj, $100.
60.Zef Selca, $100.
61.Gjergj Vuktilaj, $100.
62.Mark Vulaj, $100.
63.Sander Sinishtaj, $100.
64.Pal Zagreda, $100.
65.Euro Cut Salon, $100.
66.Pal L. Çotaj, $100.
67.Ilir Palaj, $60.
68.Gjergj Balaj, $50.
69.Nik Boga, $50.
70.Martin Çotaj, $50.
71.Nik Gjokaj, $50.
72.Gjon Gjokaj, $50.
73.Gjelosh Narkaj, $50.
74.Mond Gjoni, $30.
75.Blerim Parubi, $20.
76.Anonim, $20.

Gjithsej $13.170.

***

B. Çikago, shoqata BUZUKU

1.DGBA Fundraiser #1, IL, $700.
2.DGBA Fundraiser #2, $400.
3.Albanian Islamic Center, $2.000.
4.Mark Gjon Pema&Family,IL, $1.200
5.Luc and Viktor Brisku, IL,$600.
6.Alex & Maria Hoffman, IL, $500.
7.Filip Junkovic and Family, IL, $500.
8.Pjeter and Leke Brisku, IL,$500.
9.Steven Pekic and Family, IL, $500.
10.Zef, Steve, and Nik Lukic, IL, $400.
11.Miter Pekaj, IL,$ 300.
12.Zoran Dedic, IL, $300.
13.Anton & Tereze Nreka, IL, $250.
14.American Stone Surface, IL, $200.
15.Anton and Manda Lukic, IL, $200.
16.Frano & Roza Marovic, IL, $200.
17.Gjoke Brisku and Family, IL, $200.
18.Hasan Gjelaj and Family, IL, $200.
19.Hasan Ramushi, IL, $200.
20.Mihailo Vucic, IL, $200.
21.Niko Paladin, IL, $200.
22.Pavle Jankovic and Family, IL, $200.
23.Petar Koloviqi, IL, $200.
24.Rok & Jelena Nrekaj, IL, $200.
25.Sandro & Anna Marnikovic,IL, $200
26.Scott and Marie Schmucker, IL, $200.
27.Tom & Ana Junkovic, IL, $200.
28. Zef & Drane Junkovic and Famil, IL, $200.
29.Zija Lika, IL, $200.
30.Djok and Amy Pekic, IL, $150.
31.Samir Gjelaj, IL, $140.
32.Ilmi Kanaq, IL,$120.
33.Andrija and Lena Briskovic,IL $100.
34.Fan Nolj Cami, IL, $100.
35.Ismet Pirelli, IL, $100.
36.Musa Zendeli, IL, $100.
37.Petar Pavlovic, IL, $100.
38.Zef and Diana Pekic, IL, $100.
39.Frano & Roza Pepdjonovic, IL, $80.
40.Arben Bejleri, IL, $50.
41.David & Anna Grabowsk, $50.
42.Elton Ademi, IL, $50.
43.Jim and Lena Dawson, IL, $50.
44.Matt & Maria Weber, IL,$ 50.
45.Nick Ravelingeen, IL, $50.

Gjithsej IL $10. 490.

***

C. Shoqata Ulqini

1.Myzafer Ujkash, IL, $100.
2. Brahim Kurti, IL, $100.
3. Skender Duraku, IL, $100.
4. Naser Jahja, IL, $200.
5.Hasan Kovaci, IL, $100.
6. Metin Lukoviq, IL, $100.
7. Nadil Gjeka, IL, $100.
8.Nail Resyli, IL, $100.
9.Riza Milla, IL, $100.
10.Nazim Cuca, IL, $50.
11.Ramazan Tagani, IL, $100.
12.Myzafer Mehmeti, IL, $100.
13.Rexhep Resyli, IL, $100.
14.Dino Milla, IL, $100.
15.Mirsad Kraja, IL, $100.
16.Brahim Kraja, IL, $100.
17.Xhemal Kolari, IL, $100.
18.Sadik Metoviq, IL, $200.
19.Fadil Metoviq, IL, $100.
20.Rasim Khanaqi, IL, $100.
21.Skender Hikeziqi, IL, $100.

Gjithsej $2.250.

****

Suma e përgjithshme

A. Nju-Jork NY $13.170
B. Çikago IL $10.490
C.Shoqata Ulqini IL $2.250.
Gjithsej $25910.

Mjeku mjekon – natyra shëron.
(latine)

Mendja e shëndoshë – në trupin e shëndoshë.
(latine)

Hajrullah Koliqi

NJË FERISHTE ME KURORË

Buzëqesh Hëna, flakëron qielli,
Unë vërtet po fluturoj,
Lotët rrjedhin rr'ke prej g'zimi,
O, moj gonxhja jonë!

Shiko Kopshtin e Adënit,
Bukur është stolisur,
Një ferishte me kurorë,
Toska e Arbërisë!

Gjëja' parë që m'ra ndërmend,
Engjëlli i Perëndisë,
Sot jam gjyshi më i lumtur,
Yjet m'kanë zili!

Rrezja e dritës së mëngjesit,
Jetë të gjatë dhe fat t'uroj,
Sa t'bukur na e bëre jetën,
Ç'mrekulli kam sot në dorë!
Gjysh Lahi, 9.08.2012 (*Zgjodhi* Gjokë Dabaj).

BEJA
(Martinaj)
-A munesh me m'bâ be se nuk ma ke bâ ti atë t'keqe! – i tha njâni njanit.
-Po, n'çka t'duesh. Ndaç n'kishë, n'daç n'xhami...
-Jo, as n'kishë, as n'xhami, po thuej: Metsha pa grue n'pleqni e mos paça bukë për thmi...
-Metsha pa grue n'pleqni e mos paça bukë për thmi n't'paça gisht n'atë punë!
-E, tash ta pranoj benë, i tha, -masi m'bâne be n'dy gjânat ma t'rânsishmet (*176).
&
MJALTA
(Martinaj)
Ju ki pa smu' jarani njanit. Shkoi me pa. Ja çoi ni filxhan mjaltë. Kur e hagër, i shkreti e dveti:
-Si t'u g'ja?
-T'mirë, po pak...
-E ka bâ bleta, se ta kisha bâ û(në), t'kisha pru pa dhimtë, ia pret ai (*180).
&
KRYESORJA MOS ME KEN N'TABUT
(Martinaj)
Tue shkue n'vorrim, njâni e dvet hoxhën:
-A âsht mâ mirë me shkue para apo mas tabutit?
-Kryesorja mos me kênë n'tabut, -i thotë hoxha(*189).
*Shenja * tregon faqen e librit:* **Idriz Xh. Ulaj**, **PROZË POPULORE NGA KRAHINA E PLAVËS DHE E GUCISË**, Instituti Albanologjik Prishtinë, 2011.

KU KE ÇIKË KUR QITA PUSHKË

Ku ke çikë kur qita pushkë?
Kjesh tuj mjelë delmen kallushë.
Kjesh tuj mjelë delmen bardhokë,
Pej habijet e mjela në tokë.
I shitoftë zâna njeto flokë,
I shitoftë zâna floktë e gjata,
Kapmi nânë qitmi përmrapa,
Kapmi nânë qitmi n'shpinë,
Ta shof djalin në atë rudinë,
Çi rreptë p'e çprazë kopili alltinë,
E tânë plumat knejë po vinë
E tânë plumat po vinë pej meje,
Po don mênt me m'lujtë pej kreje!
Kam lshue flokt-o si harushë,
Djali i ri-o ish kênë tutë.
Djalë i ri-o bre mos u tut,
S'jam e egër po jam e butë,
S'jam e egër-o gjin me ngranë
Jam e butë, lezet me t'lanë!
Këndoi një grup vajzash të vëllazërisë Kukaj në bjeshkën "Bori i Kukajve"
në ditën e Shën Pjetrit më 12 korrik të vitit 1974
Shënoi: Shaban Hasangjekaj, Martinaj, Guci

Fishta (nga Lahuta e Malcis)
Ndihmò, Zot, si m'kè ndihmue!
Pesëqind vjet kishin kalue
Çëse të buk'rën ketë Shqypni
Turku e mbate në robnì,
Krejt tu' e là t'mjerën në gjak,
Frymën tue ia xanun njak,
E as tu' e lanë, jo, dritë me pà:
Kurr të keqen pa ia dà:
Rrihe e mos e lèn me kjà:
Me iu dhimbtë, po, minit n' murë,
Me iu dhimbtë gjarpnit nën gurë!
Zgjodhi Fisnik DOBRECI


Ndihmuan revistën BUZUKU-b 39
(Renditja si mbas abecedës)
Çoba'j Kols Çobs Preçit Per'Gjoks-Dedonj, Krythë, Ulqin - €10.
Leka'j Zefit Niks Leks-Brisku -€20.
Lubi Zefit Nrek'Niks-Pjetërgjon, Nilonj, Braticë, Ulqin - €50.
Stjepa'j Niks Stjeps Zefit-Pjetërgjon-Nilonj, Braticë, Ulqin, tash n'Bern, Zvicër - €50.
Xhemal Muja, Pistull - $100.

NËN NJI PEMË TË VOGËL

Nën nji pemë të vogël-o
Ish nji vashë e bukur-o
Ish e bukur porsi drita
M'u mush men'ja e grabita
Mora malin edhe* ika
Del e âma në çardak
Çudë e madhe more plak
Po vinë krushqit me bajrak
Me marrë vashën pa duvak[1]
Unë vashën s'ja'v nap aspak
Krushqt shikuen shoqi shoqin,
E u nisen rrugs me shkue
Ty e sha e ty e true
Nânë e babë kjoshin mallkue
Na pa nuse si me shkue
Na pa nuse si do t'shkojmë
Na knojnë kangën, na marrojnë
Bajraktari foli vet
Na nusen kena m'é gjetë
Morën malin, shkuen përpjetë
Kur dolën-e majevet
Gjetën nusen si lejlek
Tek i pá filloj me kjá
Ty i bâ-e temena
Trimi mirë ma bân hallall
Nânë e babë me kanë gërgâ[2]
Me kanë thanë, shko mytu n'ujë
Shkova n'ujë-e për m'u mytë
Vetë Zoti m'i çili sytë
Rob i Zotit, mos u myt.
Anmikut i plaçin sytë
Po anmiku si pëlset
Merre punën, bâne shpejt
Del nusja nëpër kojshi
Me shetit me kuneti
Del plaku nëpër mëhallë
Dvesin, nusja si t'ka dalë
Për marak, për faqe t'bardhë
M'i bân punët për pashallarë.

1.Duvak vel, mbulesë, faculetë **2.gërgâ** gërgatë.
*Shestanasit në vend *dh* përdorin *ll.*
Treguan **Angja** (23.8.1915-) dhe i nipi **Marku**'j Gjonit Markut Gjonit Gjek'Lula, Kuçe, Totosh, Ulqin, me rranxë prej Briskut (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit). *Shënoi* Simë Dobreci më 10.10.2010.


Ljare (pjesa perëndimore e Krajës), shkallët me gurë njëcopësh



Dalja në Rumi

Shkruen **Gjergji Leks Macit Kols-Perkolonj**

N'revistën BUZUKU lexova artikullin e Bahri Briskut, i cili shkruon qi asht dalë n'Rumi njiherë n'vjetë.

N'mé t'Rumisë kanë dalë katolik, musliman e ortodoks, por jo vetëm Shqyptar por elle Malazez. Dalja n'Rumi nuk ka kijen e politizuome. Asht shkuo me vullnet, me dashni, si t'ishte nji festë fetare.

Nacionalistat Serb, krye me Amfillohjen, n'atë ven ku asht mlell populli, ku asht luojtë vallja Shestanase, ku asht hjellë guri e tërhjekë konopi, ku ka vllaznuo dashnija. Serbtë n'Rumi çuon nji objekt i cilli shtriv mërzi e panreqësi popullit t'Nënrumisë. Amfillofi tregoj qi aty ku asht kisha tij, aty asht Serbija. Shum popuj tonë e gjikojnë ket ngjarje barbare. Edhe unë jam me ta.

Gjillashtu pashë qi n'Rumi kishin dalë 60 Shqyptar t'rrethit tonë. Por ata nuk kishin dalë n'Rumi me majtë adetet me dashni, por kishin dalë n'Rumi me ngulë flamurin e Shqypnisë. Sigurisht deshën me imituo Amfillofjen, se aty nuk asht Serbia, por Shqypnia. Kjartë asht treguo qi nacionalizmi mretnon. Pra, ashti si gjikuom Srbt, duhet t'gjikojmë edhe kta tjertë. Flamuri i Shqypnisë kurr nuk ka valluo n'Rumi, e as aj i Sërbisë. Rumija kurr nuk ka kijenë n'shtetin Shqyptar. Shteti shqyptar asht i formuam më 1912 n'kto kufinj qi i ka sot. Kurr anët tona nuk kanë kjenë Shqypni. Nën Turki ka kijen Shqypnia 500 vjet, ashtu kish me kijen demek e nreqtë qi sot Turku t'i kërrkonje kto vene. Kish me kijen e pranuoshme qi me flamurin Shqyptar t'valonjë elle flamuri i shtetit, se shteti i jonë nuk asht Shqypnija.

Unë n'revistën BUZUKU gjillmon i kam botuo t'panreqtat qi na kanë bo Serb e Malazez, por gjillashtu gjikonj panreqsinë qi bajnë Shqyptartë. Për muo, si asht e panreqtë kisha Serbe n'Rumi, gjillashtu gjikonj ata qi n'Rumi vijoren flamurin Shqyptar. N'kuvenin e Malit Zi, Bardhi gjillmonë ka gjikue ata qi n'Rumi venuon kishën; gjillminë ka kërkuo qi atë ta hijekun. Brisku shkruon qi qeveria ka premtuo, por pa sukses. Qeverija kishte atë gja mé bo e me qef, por janë pengime, Evropa pengon e tjera.

Ashtu si Bardhi, gjikonj ngritjen e kishës n'Rumi, ashtu duhet t'gjikonj ata qi mé Rumisë çuon flamurin Shqyptar. Me atë dalje e treguon vetvetin, se n'Rumi nuk dalen me vazhduo hadetet e moçme, por me diftuo qi Rumija asht Shqyptare. Shqypnija e madhe asht anrruo çekur, por për fat t'keq pa sukses.

Kam shum vjet mâ tepër se Bahri Brisku e se ata qi n'Rumi vihorin flamurin Shqyptar. Sigurisht qi shum mâ mirë se ata qi dolen n'Rumi e di si asht shkuo lle si asht bo mlellja n'Rumi.

Fusha e Tivarit, më 8.3.2013

Në letrën e Stipçeviqit, ndër tjera, shruen:

Slažem se s Vama, da je običaj stavljanja novca pokojniku prije nego što ga se položi u grob također dokaz albanske autohtonosti i kontinuiteta od antičkih vremena do danas.

Pajtohem me Ju, që hadeti me i lanë t'holla t'dekunit ma parë se t'shtihet n'vorr isht edhe nji vërtetim i autoktonisë t'shqyptarve dhe t'vazhdimsisë pej kohës antike e deri sot.

Dueje gjuhën tane*

Na Shestanas duhet me u burrnue me t'partë tonë. Ata e ruejtën gjuhën shqype t'moçme disa mija vjet, si dhe fenë katolike të moçme mâ se dy mi vjet.

Nji duem mé nerue vetin, duhet mé dash gjuhën vet. Po nuk e deshem gjuhën tonë, kurrkush nuk na beson qi e dona gjuhën e tjetrit. Isht njerzore, edhe gjuhën e tjetrit mé nerue.

Kur e dona, kur e nerojmë gjuhën e vet, jo vetem qi nerojmë vetvetin, por edhe familjen e vet dhe t'partë e vet, rranxën e vet e komin e vet.

Aj qi e do gjuhën e vet, aj edhe shkollohet n'gjuhën e vet. Isht vërtetue, qi thitë, nxansit qi shkollohen në gjuhën e vet, e zotnojnë dijen mâ kollaj lle mâ shpejt. Pra, ata dalin mâ t'zottë e punës se ata qi shkollohen n'gjuhën e huej.

Kurrkush nuk na e nalon qi me i pasë mishkrimet n'gjuhën shqype edhe n'duganjë, n'shitore, n'rrugë. E pse nuk i kena në shumicën e duganjve, fajin e kena vetë.

Zoti na ka krijue me kjenë të gjidhë të barabartë. Pra, administrata edhe n'gjuhën shqype duhet me kjenë zyrtare aty ku n'Mal t'Zi ka shqyptar. Pse deputettë tonë nuk e kërkojnë ket t'drejtë?! Prapë, faji jon.

T'partë tonë na suen me e dashë t'veten, e jo me hajnue, jo me marrë t'huejën. Emnat tonë familjar nuk i kanë shtonjcat -viq e -iq, pra jo Suloviq por Sulaj, jo Maleviq por Malonj ose Malaj, jo Margjelukiq por Margjelukonj ose Margjelukaj. E pse nuk i rregullojmë dokumentet personale me miemna t'vërtetë, e jo t'hajnuem! Edhe ktu faji jonë.

Shestanasit, Kranjanët, Malësorët, të gjill janë popull autokton n'Mal t'Zi, si elle t'gjill Sqyptart tjerë n'Ballkan. Ata janë stërnipat e stërmesat e ILIRVE. Ket e vërtetojnë *për shemull*: vishja e barllë, vallja si kunorë, carani i votërs, premja e muzatit për dazëm t'djalit, besimi për gjarpnin, **futja n'gojën t'deknit e nji pares metalike**, djegja e buzmit, çuemja e banirit, dalja n'mé t'bjeshsë njëherë n'vjet. T'gjilla kta hadete e besime janë t'moçme me mija vjet; na i lanë ILIRTË, e vetëm na shqyptart i ruejtëm deri sot.

Pra, t'gjill na SHQYPTART kena me çka m'u lulldue, m'u burrnue, m'u krenua.

Simë Gjon Dobreci

*Shkrimi është në gjuhën shqipe shestanase të Kranjës

U Zagrebu, 22. XII.2010.

Dragi doktore Dobreci,

Dobio sam novi (34) br. časopisa «Buzuku». Uvijek u njemu nalazim nešto o Arbanasima, što me jako veseli.

U prilogu Vam šaljem mali člančić o prethistorijskim elementima u vjerovanjima zadarskih Arbanasa. To je, ustvari, referat koji je pročitan na znanstvenom skupu u Skoplju, pa je zato malih dimenzija. O toj tematici znam sada mnogo više, a sigurno je da ću saznati još ponešto u dogledno vrijeme, jer nastavljam skupljati građu za obradu te vrlo zanimljive i vrlo značajne teme. Slažem se s Vama, da je i običaj stavljanja novca pokojniku prije nego što ga se položi u grob također dokaz albanske autohtonosti i kontinuiteta od antičkih vremena do danas.

Rukopis moje knjige «Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa» se nalazi kod izdavača. Sada predstoji vrlo zamršeni rad na pripremi za tisak. Zamršen zato, što ima u tom rukopisu mnogo tekstova (pjesama, priča, mudrih izreka) na arbanaškom govoru, pa će to malo usporiti pripreme za tisak. No, vjerujem da će knjiga biti najdalje tiskana do zagrebačkog Interlibera (koji se svake godine održava u desetom mjesecu).

Moj recenzent akademik Radoslav Katičić, vrsni stručnjak za balkanske jezike, ali i za mitologiju naroda koji žive ili koji su živjeli na ovim prostorima, bio je začuđen kada je pročitao potpoglavlje o uporabi glagoljice u Arbanasima. Nalućuje, da su možda Arbanasi upoznali glagoljicu i staroslavenski jezik već u pradomovini, jer postoje naznake da je glagoljica bila raširena sve do Albanije. I zaista, jedna moja znanica iz Elbasana (Blerina Suta) mi je spomenula, da u okolici toga grada postoji jedna crkvica na čijem se nadvratniku nalazi natpis pisan glagoljicom.. Obećala mi je, da će mi poslati fotografiju.

Jeste li Vi ikada vidjeli ili čuli da je glagoljica bila u uporabi u selima oko Skadarskog jezera? Ako je to istina, to može značiti, da su hrvatski franjevci donijeli to pismu u te krajeve, jer ne vidim tko bi drugi mogao to donijeti osim franjevaca.

Nemojte oko toga mnogo razmišljati, no ako slučajno saznate nešto o tome, javite mi.

Još jednom Vama i cijeloj obitelji SRETNE BOŽIĆNE BLAGDANE i SRETNU NOVU GODINU želi Vam